DEKRET
PËR SHPALLJEN E LIGJIT PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TE TERRORIZMIT

("Fletorja zyrtare e Malit të Zi" nr. 14/07 datë 21.12.2007, nr. 04/08 datë 17.1.2008 dhe nr. 14/12 datë 7.3.2012)

Shpall ligjin "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të miratuar nga Kuvendi i Malit të Zi në seancën e dytë të sesionit të dytë të rregullt të vitit 2007, të mbajtur më 29 nëntor 2007.

Nr.: 01-1425/2
Podgoricë, 14 dhjetor 2007

Presidenti i Malit të Zi,
Filip Vujanović, d.v.

LIGJ

"PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Objekti i ligji

Neni 1

Ky ligj rregullon masat dhe veprimet që ndërmerren për zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Pastrimi i parave

Neni 2

Për qëllimet e këtij ligji, pastrim parash konsiderohet veçanërisht:

1) zëvendësimi ose transferimi i parave ose i një pasurie tjetër duke e ditur që ato rrjedhin nga veprimtari kriminale ose nga përfshirja në këto veprimtari, për qëllime të fshehjes ose të paraqitjes së rreme të origjinës së paligjshme të këtyre parave apo të ndihmës së ofruar një personi të përfshirë në kryerjen e veprimtarisë kriminale, për të shmangur pasojat ligjore të veprimit të tij;

2) fshehja ose paraqitja e rreme e natyrës, origjinës, vendndodhjes, lëvizjes, disponimit ose pronësisë së parave ose të pasurive të tjera, duke e ditur se rrjedhin nga veprimtari kriminale ose përfshirja në këto veprimtari;

3) përvetësimi, posedimi ose përdorimi i pasurisë, duke e ditur, në momentin e përvetësimit, se kjo pasuri rrjedh nga një veprimtari kriminale ose nga përfshirja në veprimtari të tilla;

4) pjesëmarrja ose shoqërimi në kryerjen, përpjekja për të kryer dhe ndihma, nxitja, lehtësimi dhe këshillimi në lidhje me kryerjen e veprimtarisë nga pikat 1, 2 dhe 3 të këtij paragrafi.

Pastrim parash konsiderohet edhe kur veprimtaritë sipas paragrafit 1 të këtij neni kryhen në territorin e shtetit tjetër.

Financimi i terrorizmit

Neni 3

Në kontekstin e këtij ligji, financim i terrorizmit konsiderohet veçanërisht:

1) ofrimi ose marrja e letrave me vlerë, mjeteve të tjera ose pasurive, në çfarëdo lloj mënyre, direkt ose indirekt, me qëllimin për t'i përdorur ose duke qenë në dijeni se do të përdoren, në tërësi ose pjesërisht, për kryerjen e një akti terrorist, ose përpjekja për të ofruar ose marrë sa më lart;

2) nxitja ose ndihma në ofrimin ose marrjen e mjeteve ose të pasurisë nga pika 1 e këtij neni.

Tatimpaguesit

Neni 4

Masat për zbulimin ose parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ndërmerren përpara, gjatë ose pas kryerjes së një veprimi të marrjes, investimit, shkëmbimit, ruajtjes ose disponimit në ndonjë formë tjetër të parasë ose një pasurie tjetër, ose kryerja e transaksioneve kur ka dyshime se bëhet fjalë për pastrim parash ose financim të terrorizmit.

Masat sipas paragrafit 1 të këtij neni merren nga shoqëritë tregtare dhe personat e tjerë juridikë, sipërmarrësit dhe personat fizikë (në vijim referuar si: tatimpaguesit), dhe konkretisht:

1) bankat, filialet e bankave të huaja dhe institucionet financiare;
2) bankat e kursimeve dhe institucionet e kreditit;
3) institucionet për kryerjen e transaksioneve të pagesës;
4) zyrat postare;
5) shoqëritë e administrimit të fondeve të investimeve dhe filialet e shoqërive të huaja të administrimit të fondeve të investimeve;
6) shoqëritë e administrimit të fondeve të pensioneve dhe filialet e shoqërive të huaja të administrimit të fondeve të pensioneve;
7) ndërmjetësit (brokerët) e bursës dhe filialet e ndërmjetësve të bursave të huaja;
8) Shoqëritë e sigurimit, filialet e shoqërive të huaja të sigurimit që ofrojnë sigurim të jetës, shoqëritë e ndërmjetësimit dhe shoqëritë e përfaqësimit në sigurim në lidhje me sigurimin e jetës;
9) organizatorët e lotarive dhe lojërave të fatit;
10) zyrat e këmbimit valutor;
11) institucionet penglënies;
12) shoqëritë e auditimit, audituesi i pavarur dhe ligjor ose personat fizikë që ofrojnë shërbimet e kontabilitetit dhe të këshillimit tatimor, si dhe shërbime në lidhje me themelimin e shoqërive;
13) shoqëritë që ofrojnë para elektronike;
14) organizatat humanitare, joqeveritare dhe organizata të tjera jofitimprurëse;
15) shoqëritë tregtare, personat juridikë, sipërmarrësit dhe personat fizikë të përfshirë në një aktivitet ose veprimtari tregtare që lidhet me:
    - shitjen dhe blerjen e pretendimeve;
    - faktoring-un;
    - administrimin e pasurive për personave të tretë;
    - dhënien e kartave të pagesës dhe të kreditit dhe kryerjen e operacioneve me këto karta;
    - lizing-un (qiranë) financiare;
    - organizimin e udhëtimeve;
    - investimet, tregtinë dhe ndërmjetësimin në tregtinë e pasurive të paluajtshme;
    - shitjen e mjeteve motorike;
    - shitjen e mjeteve lundruese dhe të aviacionit;
    - organizimin;
    - ruajtjen në kasaforta;
    - dhënien e garancive dhe granteve të tjera;
    - kreditimin dhe ndërmjetësimin në kreditim;
    - shërbimet e kateringut;
    - huadhënien dhe ndërmjetësimin në veprimtaritë e negocimit të kredive;
    - organizimin dhe zhvillimin e ankandeve, tregtimin e objekteve kulturore, të metaleve të çmuara dhe të gurëve të çmuar, të produkteve të metaleve të çmuara dhe gurëve të çmuar, si dhe të mallrave të tjera, në qoftë se pagesa kryhet në para kesh në vlerën 15 000 euro ose më shumë, në një ose më shumë transaksione të lidhura.

Duke bërë përjashtim sipas paragrafit 2 të këtij neni, me anë të një akti nënligjor të Qeverisë së Malit të Zi (në vijim referuar si: Qeveria) mund të përcaktohen tatimpagues të tjerë të cilët duhet të ndërmarrin masat sipas paragrafit 1 të këtij neni nëse, duke pasur parasysh natyrën dhe mënyrën e zhvillimit të aktivitetit ose të veprimit, ekziston ndonjë rrezik më i madh se pastrimi i parave ose

financimi i terrorizmit, ose, në përputhje me kushtet e veçanta të standardeve ndërkombëtare, të përcaktojë tatimpaguesit që, në faza të caktuara të zhvillimit të biznesit ose të aktivitetit, nuk janë të detyruar të marrin masat dhe veprimet e përcaktuara në këtë ligj.

Përkufizime të termave

Neni 5

Termat e përdorura në këtë ligj kanë kuptimet si vijon:

1) akt terrorist është akti i përcaktuar nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për luftën kundër financimit të terrorizmit;
2) terrorist është personi i cili, i vetëm ose në bashkëpunim me persona të tjerë,:
   - kryen ose tenton të kryejë, në mënyrë direkte ose indirekte, një akt terrorist
   - nxit ose ndihmon në kryerjen e aktit terrorist;
   - në mënyrë të qëllimshme kur është në dijeni të qëllimit të një personi tjetër ose të një grupi personash për të kryer një akt terrorist, kontribuon në kryerjen e aktit terrorist;
3) organizatë terroriste është grupi i organizuar i cili:
   - në mënyrë të qëllimshme, direkte ose indirekte, kryen ose përpiqet për të kryer një akt terrorist;
   - nxit ose ndihmon në kryerjen e një akti terrorist;
   - në mënyrë të qëllimshme ose kur është në dijeni të qëllimit të një grupi njerëzish për të kryer një akt terrorist, kontribuon në kryerjen e aktit terrorist.
4) transaksion është marrja, investimi, zëvendësimi, ruajtja ose disponimi në ndonjë mënyrë tjetër i parave ose ndonjë pasurie tjetër;
5) rrezik për pastrim parash dhe financim të terrorizmit është rreziku që klienti do të shfrytëzojë sistemin financiar për pastrim parash ose financim të terrorizmit, ose që një marrëdhënie biznesi, një transaksion ose një produkt do të shfrytëzohet, në mënyrë direkte ose indirekte, për pastrim parash ose financim të terrorizmit;
6) marrëdhënie korrespondence është marrëdhënia ndërmjet një institucioni krediti vendas dhe një institucioni krediti të huaj, e cila krijohet me hapjen e llogarisë së institucionit kreditor ose të një institucioni tjetër të huaj tek institucioni kreditor vendas, ose një kontratë të lidhur midis një institucioni kreditor vendas dhe një institucioni kreditor të huaj ose një institucion tjetër, me qëllim kryerjen e biznesit me vende të tjera;
7) Bankë "guaskë" është institucioni kreditor, ose institucione të tjera të ngjashme, të cilat janë regjistruar në një shtet në të cilin nuk kryejnë veprimtari tregtare, nuk janë të pranishëm fizikisht, nuk kanë ambiente pune, punonjës, organe administrative ose menaxhimi dhe që nuk janë të lidhur me një grup financiar që i nënshtrohet mbikëqyrjes për zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave ose financimit të terrorizimit:
8) ndërmjetës në sigurim është personi i cili, në bazë të lejes nga organi rregullator, kryen veprimet e ndërmjetësimit në sigurim që konsiston në vendosjen e lidhjeve midis të siguruarit ose kontraktorit të sigurimit dhe shoqërisë së sigurimit, me qëllim negocimin për të lidhur kontratën e sigurimit, në bazë të urdhrit të shoqërisë së sigurimit ose urdhrit të të siguruarit, ose të kontraktorit të sigurimit;
9) pasuri janë aktivet materiale ose jomateriale, të luajtshme ose të paluajtshme, të trupëzuara ose të patrupëzuara dhe dokumentet ose instrumentet ligjore të çfarëdo lloj forme, përfshirë ato në formë elektronike ose dixhitale, të cilat cilësojnë të drejtën ose një interes mbi këto aktive;
10) marrëdhënie biznesi është marrëdhënia e punës, profesionale ose tregtare që lidhet me aktivitetet profesionale të institucioneve dhe personave sipas këtij ligji dhe e cila, në momentin e vendosjes së kontaktit, pritet që jetë me karakter të përhershëm;
11) identifikimi i klientit është procedura e cila përfshin:
    - përcaktimin e identitetit të klientit, ose verifikimin e identitetit të tij në bazë të burimeve të besueshme, të pavarura dhe objektive;
    - mbledhjen e të dhënave rreth klientit, ose verifikimin e të dhënave të mbledhura nga burime të besueshme, të pavarura dhe objektive.

II. DETYRIMET DHE PËRGJEGJËSITË E TATIMPAGUESIT

1. Detyrimet kryesore

Neni 6

Ky nen është fshirë. “Fletorja zyrtare e Malit të Zi” nr. 14/12)

Identifikimi i klientëve

Neni 7

Ky nen është fshirë. (“Fletorja zyrtare e Malit të Zi” nr. 14/12)

Analiza e rreziqeve

Neni 8

Tatimpaguesi ka detyrimin që të kryejë analizën për përcaktimin e përqindjes së rrezikut të një klienti të caktuar, një grupi klientësh, marrëdhënies së punës, transaksioneve ose produkteve në lidhje me mundësinë e keqpërdorimit të tyre me qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit.

Analiza sipas paragrafit 1 të këtij neni përgatitet në përputhje me udhëzimet për analizën e rrezikut.

Udhëzimet sipas paragrafit 2 të këtij neni përcaktohen nga organet mbikëqyrëse kompetente sipas nenit 86 të këtij ligji, në përputhje me dispozitën e miratuar nga ministria përgjegjëse për çështjet financiare (në vijim referuar si: Ministria).

Dispozita sipas paragrafit 3 të këtij neni përcakton në mënyrë më specifike kriteret për përpunimin e udhëzimeve (madhësinë dhe përbërjen e tatimpaguesit, vëllimin dhe llojin e operacioneve, klientët, ose produktet dhe aspekte të ngjashme).

Rastet në të cilat zbatohen masat për verifikimin e identitetit dhe monitorimin e biznesit të klientëve

Neni 9

Tatimpaguesi është i detyruar që të zbatojë masat përkatëse sipas nenit 10 të këtij ligji, dhe veçanërisht:

1) gjatë vendosjes së marrëdhënieve të biznesit me klientin;
2) gjatë një ose më shumë transaksioneve të lidhura në vlerën 15 000 euro ose në një vlerë më të madhe;
3) kur ka dyshime mbi saktësinë ose besueshmërinë e të dhënave të marra lidhur me identifikimin e klientit;
4) kur ka dyshime të arsyeshme për pastrim parash dhe financim të terrorizmit nga transaksionet ose klienti në fjalë.

Në qoftë se transaksionet sipas paragrafit 1 pikat 2 dhe 4 të këtij neni bazohen në një marrëdhënie tregtare të vendosur tashmë, tatimpaguesi është i detyruar që:

1) të verifikojë identitetin e klientit që kryen transaksionin dhe të mbledhë të dhëna shtesë, në përputhje me këtë ligj;
2) të mbledhë të dhëna mbi burimin e mjeteve financiare dhe të verifikojë përputhshmërinë e burimit të mjeteve të klientit me aktivitetin e tij tregtar, nëse klienti është person juridik, ose me profesionin, nëse është person fizik.

Organizatori i lojërave të fatit është i detyruar që gjatë kryerjes së transaksioneve në vlerën prej të paktën 2000 Euro, të vërtetojë identitetin e klientit dhe të marrë të dhënat sipas nenit 71 pika 6 e këtij ligji.

Në kontekstin e këtij ligji, vendosje e marrëdhënieve të biznesit konsiderohet edhe:

1) regjistrimi i klientit për të marrë pjesë në sistemin e organizimit të lojërave të fatit tek organizatori që organizon lojëra fati nëpërmjet internetit ose mjeteve të tjera të telekomunikacionit;
2) aksesimi i klientit në të drejtat e menaxhimit të një fondi të përbashkët tek shoqëria e

administrimit.

Masat që duhet të marrë tatimpaguesi për verifikimin dhe monitorimin e klientëve

Neni 10

Tatimpaguesi është i detyruar që të zbatojë masat e verifikimit dhe monitorimit të klientëve, dhe veçanërisht:

1) të kryejë identifikimin dhe verifikimin e klientit dhe të pronarit real, në qoftë se klienti është person juridik;
2) të nxjerrë të dhëna për qëllimin dhe natyrën e marrëdhënieve të biznesit ose transaksionit dhe të dhënat e tjera në përputhje me këtë ligj;
3) të ndjekë rregullisht veprimet e biznesit që ndërmerr klienti tek tatimpaguesi dhe të vërtetojë përputhshmërinë e tyre me natyrën e marrëdhënieve të punës dhe vëllimin e zakonshëm dhe llojin e biznesit të klientit.

Kontrolli i klientit gjatë vendosjes së marrëdhënieve të biznesit

Neni 11

Tatimpaguesi është i detyruar që masat sipas nenit 10 pikat 1 dhe 2 të këtij ligji t'i zbatojë para vendosjes së marrëdhënieve të biznesit.

Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, tatimpaguesi, masat sipas nenit 10 pikat 1 dhe 2 të këtij ligji, mund t'i zbatojë edhe gjatë vendosjes së marrëdhënieve të biznesit me klientin, në qoftë se sipas vlerësimit të tij kjo është e domosdoshme dhe në qoftë se ekziston një rrezik i parëndësishëm lidhur me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit.

Tatimpaguesi sipas nenit 4 paragrafi 2 pika 8 të këtij ligji, gjatë lidhjes së kontratës për sigurimin e jetës, mund të kryejë kontroll të klientit nga kontrata e sigurimit edhe pas mbylljes së kësaj kontrate, dhe të paktën kur klienti sipas policës së sigurimit mund të realizojë të drejtat e tij.

Në qoftë se të dhënat për identitetin e klientit sipas paragrafit 3 të këtij neni nuk mund të merren, marrëdhënia e biznesit nuk duhet të vendoset dhe nëse është vendosur tashmë, ajo duhet të ndërpritet.

Kontrolli i klientit para kryerjes së transaksionit

Neni 12

Gjatë kryerjes së transaksionit sipas nenit 9 paragrafi 1 pika 2 e këtij ligji, tatimpaguesi duhet t'i zbatojë masat sipas nenit 10 pikat 1 dhe 2 të këtij ligji para kryerjes së transaksionit.

Në qoftë se të dhënat për identitetin e klientit nuk mund të merren, marrëdhënia e punës nuk duhet të vendoset dhe transaksioni nuk duhet të kryhet.

Transferimi elektronik i parave

Neni 12a

Tatimpaguesi i cili kryen shërbimet e pagesave ose të transferimit të parave duhet të mbledhë të dhëna të sakta e të plota për paguesin dhe t'i hedhë ato në formular ose mesazhin që shoqëron transfertën elektronike të mjeteve financiare, të dërguara dhe të pranuara në çdo valutë që është objekt i transfertës elektronike.

Të dhënat sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të shoqërohen me transfertën e mjeteve financiare gjatë kalimit përmes zinxhirit të pagesave.

Ofruesi i shërbimeve të pagesave ose transfertës së parave, i cili është ndërmjetës ose marrës i mjeteve financiare, do të refuzojë të kryejë transfertë të mjeteve financiare në qoftë se të dhënat për paguesin nuk janë të plota ose do të kërkojë plotësimin e të dhënave rreth paguesit në afatin më të shkurtër të.

Në procedurën e mbledhjes së të dhënave sipas paragrafit 1 të këtij neni, ofruesi i shërbimit të pagesave ose transfertave të parave kryen identifikimin e paguesit në bazë të të dhënave personale të dhëna nga organi kompetent.

Përmbajtja dhe lloji i të dhënave sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe aktivitetet e tjera të ofruesit të

shërbimit të pagesave ose të transferimit të parave, si dhe përjashtimet në grumbullimin e të dhënave gjatë transferimit të mjeteve monetare që nuk përfaqëson rrezik të parëndësishëm për pastrim parash ose financim të terrorizmit, rregullohen nga afër me akt nënligjor të Ministrisë.

Përjashtimet nga zbatimi i masave të verifikimit dhe monitorimit të klientëve

Neni 13

Shoqëria e sigurimit e cila kryen punët e sigurimit të jetës dhe filialet e shoqërive të huaja të sigurimit të cilat kanë licencë për zhvillim të aktivitetit të sigurimit të jetës në Malin e Zi, themeluesit, administruesit e fondeve të pensioneve dhe personat juridik dhe fizik të cilat kryejnë punët e përfaqësuesit dhe ndërmjetësimit në sigurim në rast të përfundimit të kontratës për sigurimin jetësor, nuk janë të detyruar të zbatojnë masat e verifikimit dhe monitorimit të klientit gjatë:

1) lidhjes së kontratës së sigurimit të jetës, ku një këst i vetëm i primit ose disa këste sigurimi, të cilat duhen paguar në një vit kalendarik, nuk kalon vlerën e përgjithshme prej 1000 euro ose në qoftë se pagesa e vetme e primit nuk kalon vlerën prej 2500 euro;
2) mbylljes së biznesit të sigurimit të pensioneve, me kusht që bëhet fjalë për:
   - sigurim në kuadrin e të cilit nuk është e mundur që polica e sigurimit nuk mund t'i transferohet një personi të tretë ose të përdoret si garanci për marrjen e kredisë ose huasë;
   - sigurimin kolektiv që siguron të drejtën për pension.

Shoqëritë vendase dhe të huaja dhe filialet e shoqërive të huaja që ofrojnë para në mënyrë elektronike nuk duhet të zbatojnë masat e verifikimit dhe të monitorimit të klientit gjatë:

1) dhënies së parasë elektronike, në qoftë se vlera e njëhershme e pagesës së kryer për dhënien e kësaj paraje ndaj bartësit elektronik të të dhënave, në të cilin nuk është mundur që të investohet përsëri para, nuk e kalon shumën prej 150 eurosh;
2) dhënies dhe biznesit në para elektronike, në qoftë se vlera e përgjithshme e pagesave të kryera është ruajtur në bartësin elektronik të të dhënave, në të cilin mund të investohet përsëri para, por që në vitin kalendarik në vijim nuk e kalon shumën prej 2500 euro, vetëm në qoftë se poseduesi i parave elektronike në vitin respektiv kalendarik jep kesh jo më pak se 1000 euro.

Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen për rastet kur, në lidhje me transaksionin ose klientin, nuk ekzistojnë arsye për të dyshuar se kemi të bëjmë me pastrim parash ose financim të terrorizmit.

2. Zbatimi i masave të kontrollit të klientit

Përcaktimi dhe verifikimi i identitetit të personit fizik

Neni 14

Për klientët që janë persona fizikë, ose për përfaqësuesit ligjorë, sipërmarrësit, ose personat fizikë që kryejnë aktivitetin, tatimpaguesi përcakton dhe verifikon identitetin e klientëve përmes kontrollit në dokumentet personale në praninë tyre dhe siguron të dhënat sipas nenit 71 pika 4 të këtij ligji. Në qoftë se të dhënat e kërkuara nuk mund të merren nga dokumentet e identifikimit të dorëzuara, të dhënat që mungojnë merren nga ndonjë dokument tjetër publik të vlefshëm që disponon klienti.

Identiteti i klientit sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të përcaktohet në bazë të vërtetimit elektronik kualifikues të klientit, të cilin e ka dhënë ofruesi i shërbimit të certifikimit në bazë të dispozitave për nënshkrimin elektronik dhe biznesin elektronik.

Tatimpaguesi në kuadrin e përcaktimit dhe verifikimit të identitetit të klientit në mënyrën e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, përshkruan të dhënat për klientin nga certifikimi i kualifikuar elektronik në regjistrin e të dhënave sipas nenit 70 të këtij ligji. Të dhënat të cilat nuk mund të sigurohen nga vërtetimi i kualifikuar elektronik, nxirren nga kopja e dokumentit personal që klienti i dërgon tatimpaguesit me shkrim ose në formë elektronike, dhe nëse nuk është e mundur që të gjitha të dhënat e përshkruara të sigurohen në këtë mënyrë, të dhënat që mundojnë merren drejtpërdrejt nga klienti.

Ofruesi i shërbimeve të certifikimit sipas paragrafit 2 të këtij neni, i cili i ka dhënë klientit vërtetim elektronik të kualifikuar, është i detyruar që me kërkesë të tatimpaguesit, të dorëzojë pa

vonesë të dhënat për mënyrën në të cilën ka përcaktuar dhe verifikuar identitetin e klientit që zotëron vërtetim elektronik të kualifikuar.

Përcaktimi dhe verifikimi i identitetit të klientit me përdorimin e vërtetimit të kualifikuar elektronik nuk lejohet:

1) Gjatë hapjes së llogarisë tek tatimpaguesi sipas nenit 4 paragrafi 2 pikat 1 dhe 2 të këtij ligji, përjashtuar rastin e hapjes së depozitës së llogarisë së përkohshme depozituese për pagesën e kapitalit themelues;
2) Në qoftë se ka dyshime që vërtetimi kualifikues elektronik është keqpërdorur, pra në qoftë se tatimpaguesi përcakton se janë modifikuar rrethana të cilat janë me rëndësi të thelbësore ndaj vlefshmërisë së vërtetimit.

Në qoftë se tatimpaguesi gjatë përcaktimit dhe verifikimit të identitetit të klientit dyshon në vërtetësinë e të dhënave të marra ose në besueshmërinë e dokumenteve dhe dokumentacionit tjetër të biznesit nga i cili janë nxjerrë të dhënat, është i detyruar që të kërkojë deklaratë me shkrim nga klienti.

Përcaktimi dhe verifikimi i identitetit të personit juridik

Neni 15

Tatimpaguesi përcakton dhe verifikon identitetin e klientëve që janë persona juridikë dhe nxjerr të dhënat sipas nenit 71 pika 1 të këtij ligji përmes kontrollit të dokumentit origjinal ose të kopjes së noterizuar të dokumentit të lëshuar nga Regjistri Qendror i Subjekteve tregtare (në vijim referuar si: RQST) ose të regjistrit tjetër përkatës publik, që dorëzohet në emër të përfaqësuesit të personit juridik.

Dokumenti sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk duhet të jetë më i vjetër se tre muaj nga data e dhënies.

Tatimpaguesi mund të përcaktojë dhe verifikojë identitetin e personit juridik dhe të nxjerrë të dhënat sipas nenit 71 pika 1 të këtij ligji edhe përmes kontrollit në RQST ose në ndonjë regjistër tjetër përkatës publik. Në ekstraktin nga regjistri në të cilin është kryer kontrolli, tatimpaguesi paraqet datën dhe orën dhe emrin personal të personit që ka kryer kontrollin. Ekstraktin nga regjistri, organizata e ruan në bazë të ligjit.

Të dhënat sipas nenit 71 pikat 2, 7, 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14 të këtij ligji, tatimpaguesi i nxjerr përmes kontrollit në kopjet origjinale ose të noterizuara të dokumenteve dhe çdo dokumentacioni tjetër të biznesit. Në qoftë se të dhënat nuk mund të merren nga kontrolli në dokumente dhe në dokumentacion, të dhënat që mungojnë merren drejtpërdrejt nga përfaqësuesi ose person i autorizuar.

Kopjen origjinale ose të noterizuar të dokumentit, tatimpaguesi e mban në dokumentacionin e tij.

Në qoftë se tatimpaguesi gjatë përcaktimit dhe verifikimit të identitetit të personit juridik dyshon në vërtetësinë e të dhënave të marra ose në besueshmërinë e dokumenteve dhe të dokumentacionit tjetër të biznesit nga i cili janë marrë të dhënat, është i detyruar që nga personi përfaqësues ose i autorizuar para vendosjes së marrëdhënieve të biznesit ose kryerjes së transaksionit të marrë edhe deklaratë me shkrim.

Në qoftë se pala është person juridik i huaj, i cili kryen aktivitet në Malin e Zi nëpërmjet njësisë së tij të biznesit, tatimpaguesi përcakton dhe verifikon identitetin e personit juridik të huaj dhe njësinë e tij të biznesit.

Përcaktimi dhe verifikimi i identitetit të përfaqësuesit të personit juridik.

Neni 16

Tatimpaguesi përcakton dhe verifikon identitetin e përfaqësuesit dhe nxjerr të dhënat sipas nenit 71 pika 2 të këtij ligji përmes kontrollit në dokumentin personal të përfaqësuesit, në prani të këtij të fundit. Në qoftë se nga kontrolli në dokumentin personal nuk mund të përcaktohen të gjitha të dhënat e parashikuara, të dhënat që mungojnë merren nga dokumente të tjera publike, të dorëzuara nga përfaqësuesi, pra personi i autorizuar.

Në qoftë se tatimpaguesi gjatë përcaktimit dhe verifikimit të identitetit të përfaqësuesit dyshon në vërtetësinë e të dhënave të nxjerra, është i detyruar të kërkojë edhe deklarimin e tij me shkrim,

Përcaktimi dhe verifikimi i identitetit të personit të autorizuar

Neni 17

Në qoftë se marrëdhënien e biznesit në emër të klientit, personit juridik, e themelon person i autorizuar, tatimpaguesi përcakton dhe verifikon identitetin e personit të autorizuar dhe nxjerr të dhënat sipas nenit 71 pika 2 të këtij ligji përmes kontrollit në dokumentin personal të personit të autorizuar dhe në prani të tij. Në qoftë se nga të dhënat personale nuk është e mundur të përcaktohen të gjithë të dhënat e parashikuara, të dhënat e munguara nxirren nga dokumente të tjera publike, të dorëzuara nga personi i autorizuar.

Të dhënat sipas paragrafit 1 të këtij ligji për përfaqësuesin, në emër të të cilit vepron personi i autorizuar, tatimpaguesi i merr nga autorizimi me shkrim i noterizuar, lëshuar nga përfaqësuesi.

Në qoftë se transaksioni sipas nenit 9 paragrafi 1 pika 2 të këtij ligji në emër të palës kryhet nga personi i autorizuar, tatimpaguesi kryen verifikimin e identitetit të personit të autorizuar dhe merr të dhënat sipas nenit 71 pika 3 të këtij ligji për klientin i cili është personi fizik, sipërmarrësi ose personi fizik cili kryen aktivitetin.

Në qoftë se tatimpaguesi gjatë përcaktimit dhe verifikimit të identitetit të përfaqësuesit dyshon në vërtetësinë e të dhënave të marra, është i detyruar që të marrë edhe deklarimin e tij me shkrim.

Raste të veçanta përcaktimi dhe verifikimi të identitetit të klientit

Neni 18

Identiteti i klientit, në bazë të nenit 7 të këtij ligji, përcaktohet dhe verifikohet veçanërisht:

1) Gjatë hyrjes së klientit në ambientet në të cilat organizohen lojëra të veçanta fati;
2) Gjatë çdo afrimi tek kasaforta e qiramarrësit ose e përfaqësuesit të tij, pra e personit që ka autorizuar

Gjatë përcaktimit dhe verifikimit të identitetit të palës në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, organizatori i lojërave të fatit ose tatimpaguesi, i cili kryen veprimtarinë e ruajtjes në kasaforta, nxjerr të dhënat sipas nenit 71 pikat 6 dhe 8 të këtij ligji.

3. Identifikimi i pronarit të vërtetë

Pronari i vërtetë

Neni 19

Pronar i vërtetë është person fizik i cili ka në pronësi ose kontrollon klientin, pra person fizik, në emër të të cilit kryhet transaksioni, si dhe personi i cili kryen kontrollin efektiv ndaj personit juridik ose veprimit juridik.

Pronar i vërtetë i shoqërisë tregtare, domethënë i personit juridik, në përmbajtje të këtij ligji, konsiderohet:

1) Personi fizik i cili zotëron, në mënyrë direkte ose indirekte, 25% të aksioneve të biznesit, të drejtë vote ose të drejta të tjera, në bazë të të cilave merr pjesë në administrim, pra merr pjesë në kapital duke zotëruar mbi 25% të tij, ose ka ndikim vendimtar në administrimin e mjeteve të shoqërisë tregtare, pra të personit juridik.
2) Person fizik i cili shoqërisë tregtare, pra personit fizik direk i siguron ose garanton mjete dhe në bazë të kësaj, ka të drejtë që të ndikojë në mënyrë vendimtare ndaj miratimit të vendimeve të organeve administrative të shoqërisë tregtare, pra të personit juridik gjatë vendimmarrjes mbi financimin dhe operacionet.

Pronar i vërtetë i personit juridik të huaj (trust, fond etj.) i cili merr, administron dhe kryen shpërndarjen e aseteve të pronës për qëllime të caktuara, në përmbajtje të këtij ligji, konsiderohet:

1) Personi fizik i cili, direkt ose indirekt, disponon të paktën 25% të pasurisë së personit juridik ose të subjektit të ngjashëm të personit të huaj juridik;
2) Personi fizik të cilit i është caktuar ose mund t'i caktohet si klient të paktën 25% e të ardhurave nga pasuria që administron.

Identifikimi i pronarit të vërtetë të personit juridik ose subjektit juridik të huaj

Neni 20

Tatimpaguesi është i detyruar të përcaktojë pronarin e vërtetë të një personi juridik ose të personit të huaj juridik duke marrë të dhënat sipas nenit 71 paragrafi 15 të këtij ligji.

Të dhënat në bazë të paragrafit 1 të këtij Neni, tatimpaguesi do t'i marrë nga kopjet origjinale ose të certifikuara të dokumentacionit nga RQST ose nga një regjistër tjetër përkatës publik, i cili nuk duhet të jetë më I vjetër se tre muaj nga data e lëshimit ose i siguruar me anë të kontrollit të RQST ose të një regjistri tjetër publik në përputhje me nenin 14, pikat 3 dhe 5 të këtij ligji.

Në qoftë ne të dhënat e kërkuara nuk mund të sigurohen në mënyrën e përcaktuar sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, të dhënat e munguara do të sigurohen me deklarim me shkrim nga një përfaqësues ose person I autorizuar.

Informacioni mbi pronarët e vërtetë të personit juridik ose të një personi të ngjashëm juridik të huaj, verifikohen në masën me të cilën sigurohet një panoramë e qartë dhe e plotë ndaj pronësisë të vërtetë dhe organit të menaxhimit të klientit për sa I përket vlerësimeve të shkallës së rrezikut.

4. Marrja e informacionit në lidhje me klientin, për marrëdhënien me biznesin, për produktin ose transaksionin

Neni 21

Tatimpaguesi, nën kontrollin e klientit sipas nenit 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1 të këtij ligji, merr të dhënat dhe mban regjistrat sipas neni 71 pikat 1, 2, 4, 5, 7, 8 dhe 15 të këtij ligji.

Tatimpaguesi është I detyruar që në kuadër të kontrollit të klientit sipas nenit 9 paragrafi 1 pika 2 të këtij ligji, të marrë të dhëna dhe të mbajë regjistrin sipas nenit 71 pikat 1, 2, 3, 4, 5, 9, 10, 11, 12, 13 dhe 15 të këtij ligji.

Në kuadër të kontrollit të klientit sipas nenit 9 paragrafi 1 pikat 3 dhe 4 të këtij ligji, tatimpaguesi ka detyrimin që të marrë të dhënat dhe të administrojë regjistrin sipas nenit 71 të këtij ligji.

5. Monitorimi e aktiviteteve të bizneseve

Neni 22

Tatimpaguesi ka detyrimin që të vëzhgojë aktivitetet e biznesit të klientit që përfshijnë burimet e mjeteve me të cilat operon.

Monitorimi i veprimtarive të biznesit sipas paragrafit 1 të këtij neni tek tatimpaguesi, përfshin veçanërisht:

1) verifikimin e përputhshmërisë së biznesit të klientit me natyrën dhe qëllimin e marrëdhënies kontraktuale;
2) monitorimin dhe kontrollin e përputhshmërisë së biznesit të klientit me volumin e tij të zakonshme të biznesit;
3) monitorimin dhe përditësimin e rregullt të dokumenteve dhe të të dhënave të klientit, e cila përfshin administrimin e kontrollit përsëritë vjetor të klientit në rastet sipas nenit 23 të këtij ligji.

Tatimpaguesi është i detyruar të sigurojë dhe përshtatë dinamikën e zbatimit të masave sipas paragrafit 1 të këtij neni, rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, me të cilin tatimpaguesi është i ekspozuar gjatë kryerjes së një veprimi të caktuar, ose në biznesin me klientin.

Riauditimi vjetor i personit të huaj juridik

Neni 23

Nëse një shtetas juridik i huaj kryen transaksionet sipas nenit 9, paragrafi 1 ndaj një tatimpaguesi, ky i fundit ka detyrimin që, përveç monitorimit të aktiviteteve të biznesit sipas nenit 22 të këtij ligji, të kryejë kontrollin e përsëritur vjetor të personit juridik të huaj të paktën një herë në vit dhe në jo më vonë se një vit pas kontrollit të fundit të palës.

Duke bërë përjashtim sipas paragrafit 1 të këtij neni, tatimpaguesi duhet të kryejë rikontroll, të paktën një herë në vit dhe jo më vonë se një vit pas kryerjes së kontrollit të fundit të klientit, kur klienti që kryen transaksionet sipas nenit 9 paragrafi 1 të këtij ligji është person juridik me seli në Mal të Zi dhe në qoftë se kapitali i huaj i këtij personi juridik përbën të paktën 25%.

Rikontrolli i klientit sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni përfshin:

1) marrjen ose verifikimin e të dhënave rreth shoqërisë, adresës dhe zyrës së regjistruar;
2) marrjen e të dhënave rreth emrit dhe vendbanimit ose vendqëndrimit të përfaqësuesit;
3) marrjen e të dhënave rreth përfituesit; dhe
4) marrjen e një autorizimi të ri sipas nenit 17 paragrafi 2 të këtij ligji.

Nëse një njësi biznesi e një personi juridik të huaj kryen transaksionet sipas nenit 9 paragrafi 1 të këtij ligji në emër dhe për llogari të një personi juridik të huaj, tatimpaguesi, gjatë rikontrollit të personit juridik të huaj, përveç të dhënave sipas paragrafit 3 të mësipërm, merr edhe:

1) të dhënat për adresën dhe selinë të njësisë së biznesit të personit juridik të huaj;
2) të dhëna lidhur me emrin dhe vendndodhjen e njësive të biznesit të personit juridik të huaj.

Të dhënat sipas paragrafit 3 pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, tatimpaguesi i merr nga kontrolli i kopjes origjinale ose të certifikuar të dokumentacionit nga RQST ose nga një regjistër tjetër përkatës publik të lëshuar gjatë tre muajve të fundit, ose nga kontrolli i RQST -së ose një regjistri tjetër përkatës publik. Nëse të dhënat e parashikuara nuk mund të merren duke kontrolluar dokumentacionin, ato merren nga kopjet origjinale ose të certifikuara të dokumenteve dhe dosjeve të tjera të biznesit, që personat juridikë i përcjellin tatimpaguesit me kërkesë të këtij të fundit, ose drejtpërdrejt nga një deklaratë me shkrim e përfaqësuesit të personit juridik sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni.

Duke bërë përjashtim sipas paragrafëve 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij neni, tatimpaguesi detyrohet të kryejë rikontroll të personit të huaj sipas nenit 29 paragrafi 1 të këtij ligji.

6. Forma të veçanta të verifikimit dhe monitorimit të klientëve

Neni 24

Forma të veçanta të verifikimit dhe monitorimit të klientëve, në kontekstin e këtij ligji janë:

1) verifikimi dhe monitorimi i detajuar i klientit;
2) kontrolli i thjeshtëzuar i klientit.

Verifikimi dhe monitorimi i detajuar i klientit

Neni 25

Tatimpaguesi është i detyruar të kryejë verifikimin e detajuar të klientit në rastin kur ai vlerëson se ekziston rrezik i lartë për pastrim parash dhe financim të terrorizmit.

Tatimpaguesi duhet të marrë masat e verifikimit dhe monitorimit të detajuar edhe në situatat e mëposhtme:

1) kur hyn në marrëdhënie të llogarisë së hapur me një bankë ose me një institucion kreditues të ngjashëm me seli jashtë BE-së ose jashtë shteteve të listës;
2) hyn në marrëdhënie biznesi ose kryen transaksionet e përcaktuara në nenin 9 paragrafi 1 pika 2 të këtij ligji me një klient që është eksponent politik sipas nenit 27 të këtij ligji;
3) kur klienti nuk është i pranishëm gjatë procesit të verifikimit të identitetit të tij.

Tatimpaguesi është i detyruar që masat e verifikimit dhe monitorimit të detajuar të klientit t'i zbatojë në rastet kur, në përputhje me nenin 8 të këtij ligji, vlerëson se për shkak të natyrës së marrëdhënies së biznesit, formës dhe mënyrës së kryerjes së transaksionit, profilit të biznesit të klientit ose rrethanave të tjera që lidhen me klientin, ekziston ose mund të lindë një rrezik i lartë për pastrim parash ose financim terrorizmit.

Marrëdhëniet bankare korresponduese me institucione krediduese në vende të tjera

Neni 26

Gjatë vendosjes së marrëdhënieve të korrespondencës me një bankë ose një institucion tjetër të ngjashëm kreditues me seli jashtë BE-së ose jashtë shteteve të listës, tatimpaguesi identifikon dhe verifikon klientin në përputhje me nenin 10 të këtij ligji dhe merr të dhënat e mëposhtme:

1) datën e lëshimit dhe periudhën e vlefshmërisë së lejes për ofrimin e shërbimeve bankare dhe emrin dhe zyrën e regjistruar të organit kompetent shtetëror që ka lëshuar lejen;
2) përshkrimin e zbatimit të procedurave të brendshme që lidhen me zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit dhe veçanërisht të

procedurave për: verifikimin e klientit, përcaktimin e përfituesit, raportimin e të dhënave mbi transaksionet dhe klientët e dyshimtë autoriteteve kompetente, mbajtjen e regjistrave, auditimin e brendshëm dhe procedurat e tjera të përcaktuara nga banka ose institucione të tjera kredidhënëse për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

3) përshkrimin e strukturës së sistemit për zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit që zbatohet në shtete të tjera në të cilat një bankë ose institucion kreditit i ngjashëm ka një zyrë të regjistruar ose është regjistruar;
4) deklaratën me shkrim të bankës ose një institucioni tjetër kreditues të ngjashëm në shtetin ne të cilin ka zyrën e regjistruar ose është regjistruar, sipas mbikëqyrjes juridike që, në përputhje me ligjet e atij shteti, duhet të zbatojë rregulloret përkatëse në fushën e zbulimit dhe parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
5) deklaratën me shkrim të bankës ose të një institucioni kreditues të ngjashëm që dëshmon se ai operon si bankë guaskë;
6) deklaratën me shkrim që banka ose një institucioni kreditor tjetër i ngjashëm kreditues nuk ka hyrë ose nuk do të hyjë në marrëdhënie biznesi dhe nuk do të kryejë transaksione me banka guaska;
7) deklaratën me shkrim që banka ose një institucion tjetër i ngjashëm kreditues, në raport me llogarinë ndërmjetëse, ka konfirmuar identitetin dhe ka kryer verifikim të vazhdueshëm të klientëve që kanë akses të drejtpërdrejtë në llogarinë e korrespondentit dhe se është e aftë t'i sigurojë të dhënat përkatëse nga procedura e verifikimit të klientit.

Të dhënat sipas paragrafit 1 të këtij neni, tatimpaguesi i merr nga regjistrat publikë të të dhënave ose nga regjistra të tjerë të disponueshëm, ose nga dokumente dhe dokumentacionet e biznesit të dërguara nga bankat ose institucionet e tjetra të ngjashme krediduese me seli jashtë BE-së ose jashtë shteteve në listë.

Personat e ekspozuar politikisht

Neni 27

Person i ekspozuar politikisht në kontekstin e këtij ligji konsiderohet personi fizik i cili ka ose ka pasur gjatë vitit të mëparshëm një pozicion publik të njohur në Malin e Zi, në shtet tjetër ose në nivel ndërkombëtar, përfshirë anëtarët e familjes së tij të drejtpërdrejtë dhe bashkëpunëtorët e afërt, si më poshtë:

1) kryetarët e shteteve, kryetarët e qeverive, ministrat dhe zëvendësuesit ose ndihmesat e tyre, drejtuesit e organeve administrative dhe të organeve të njësive të qeverisjes vendore, përfshirë dhe zëvendësit ose ndihmësit e tyre dhe funksionarë të tjerë;
2) përfaqësuesit e zgjedhur të organeve legjislative;
3) mbajtësit e funksioneve më të larta juridike dhe kushtetuese gjyqësore;
4) anëtarët e gjykatave ose të institucioneve të larta audituese dhe të këshillave të bankave qendrore;
5) këshilltarët, ambasadorët dhe përgjegjësit e lartë të forcave të armatosura;
6) anëtarët e organeve administrative dhe mbikëqyrëse të shoqërive pjesa më e madhe e të cilave janë në pronësi të shtetit.

Anëtarë të familjes së ngushtë të personave sipas paragrafit 1 të këtij nen konsiderohen partnerët në martesë ose jashtë-martese dhe fëmijët e lindur nga një marrëdhënie martesore ose jashtë martesore dhe bashkëshortët e tyre në martesë ose jashtë martese, prindërit, vëllezërit dhe motrat.

Bashkëpunëtor i ngushtë i personit sipas paragrafit 1 të këtij neni konsiderohet:

1) personi fizik që ka pronësi të përbashkët mbi personin juridik, ka vendosur marrëdhënie biznesi ose një lloj tjetër marrëdhënieje të afërt biznesi me personin e ekspozuar politikisht.
2) personi fizik që ka pronësi mbi personin juridik ose ka hyrë në marrëdhënie biznesi në interes të personit të ekspozuar politikisht.

Në kuadrin e verifikimit të thelluar të klientit sipas paragrafit 1 të këtij neni, tatimpaguesi ka detyrimin që krahas masave të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji:

1) të sigurojë të dhëna mbi burimin e mjeteve dhe pasurisë që është objekt i marrëdhënieve të

biznesit ose transaksionit nga dokumentet personale ose dokumente të tjera të dorëzuara nga klienti dhe, nëse të dhënat e përshkruara nuk mund të sigurohen nga dokumentet e dorëzuara, t'i marrë dhënat drejtpërdrejt me anë të një deklarate me shkrim të klientit;

2) të marrë miratimin me shkrim të personit përgjegjës përpara vendosjes së marrëdhënies së biznesit me klientin;
3) pas vendosjes së marrëdhënies së biznesit, të monitorojë me kujdes të veçantë transaksionet dhe veprimtaritë e tjera tregtare të kryera nga personi i ekspozuar politikisht me një institucion të caktuar.

Tatimpaguesi përcakton procedurën e identifikimit të personit të ekspozuar politikisht me anë të një rregulloreje të brendshme, në përputhje me udhëzimet e organit mbikëqyrës kompetent.

Lista e personave të ekspozuar politikisht sipas paragrafit 1 të këtij neni, publikohet në faqen e internetit të organit administrativ kompetent.

Verifikimi i identitetit të klientit në mungesë

Neni 28

Në qoftë klienti nuk është i pranishëm gjatë procesit të verifikimit të identitetit të tij, tatimpaguesi është i detyruar që në kuadrin e verifikimit të thelluar të klientit, krahas masave përkatëse sipas nenit 10 të këtij ligji, të marrë një ose disa masa shtesë dhe, konkretisht:

1) marrjen e dokumenteve, të dhënave ose informacioneve shtesë, në bazë të të cilave vërtetohet identiteti i klientit;
2) verifikimin e dokumenteve të dorëzuara dhe marrjen e një vërtetimi nga një institucion financiar ose një bankë që kryen operacione pagesash, ku të cilësohet se pagesa e parë e klientit është paguar në llogarinë në institucionin financiar përkatës.

Teknologjitë e reja

Neni 28a

Bankat dhe institucionet e tjera financiare janë të detyruara të marrin masa dhe veprime për eliminimin e rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit që mund të lindin nga zbatimi i teknologjive të reja që mundësojnë anonimitetin (operacionet bankare në internet, përdorimi i bankomateve, operacionet bankare përmes telefonit etj.).

Bankat dhe institucionet e tjera financiare miratojnë procedurat e brendshme për parandalimin e përdorimit të teknologjive të reja për qëllime të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit.

Verifikimi i thjeshtëzuar dhe ndjekja e klientit

Neni 29

Në qoftë se në lidhje me klientin ose transaksionin sipas nenit 9 paragrafi 1 pikat 1 dhe 2 të këtij ligji nuk ka dyshime të arsyeshme për pastrim parash ose financim të terrorizmit, tatimpaguesi mund t'i thjeshtëzojë procedurat e verifikimit dhe të ndjekjes së klientëve si më poshtë vijon:

1) tatimpaguesit sipas nenit 4 paragrafi 2 pikat 1, 2, 4, 5, 6, 8 dhe 9 të këtij ligji ose institucione të tjera përkatëse me seli në një shtet të BE-së ose në një shtet të përfshirë në listën e shteteve që zbatojnë standardet ndërkombëtare për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, të cilat janë në nivelin e standardeve të BE-së ose të një niveli më të lartë;
2) organet shtetërore ose organet e qeverisjes vendore, si dhe personat juridikë që kryejnë funksione publike;
3) shoqëritë, letrat me vlerë të të cilave janë përfshirë në tregun e organizuar ose në bursë në shtetet anëtare të BE-së ose në shtete të tjera në të cilat në bursa zbatohen standardet ndërkombëtare të cilat janë në nivelin e standardeve të BE-së ose të një niveli më të lartë;

Lista e shteteve sipas paragrafit 1 të këtij neni publikohet në faqen e internetit të organit administrativ kompetent.

Marrja dhe verifikimi i të dhënave të klientit

Neni 30

Verifikimi dhe monitorimi i thjeshtuar i klientëve sipas nenit 29 të këtij ligji përfshin marrjen e të dhënave të mëposhtme:

1) Gjatë vendosjes së marrëdhënies së biznesit, të dhëna për:
   - shoqërinë dhe selinë e personit juridik i cili vendoset ose në emër dhe për llogari të të cilit vendoset marrëdhënia e biznesit;
   - Emrin personal të përfaqësuesit ose të personit të autorizuar i cili themelon marrëdhënie biznesi për personin juridik;
   - qëllimin, natyrën dhe datën e vendosjes së marrëdhënies së biznesit;
2) Gjatë kryerjes së transaksioneve sipas nenit 9 paragrafi 1 pika 2 të këtij ligji, të dhëna për:
   - shoqërinë dhe selinë e personit juridik në emër dhe për llogari të cilit kryhet transaksioni;
   - emrin e përfaqësuesit ose të personi të autorizuar që kryen transaksion për llogari të personit juridik;
   - datën dhe orën e kryerjes së transaksionit;
   - vlerën e transaksionit, valutën dhe mënyrën e kryerjes së transaksionit
   - qëllimin e transaksionit dhe emrin personal dhe vendbanimin e përhershëm, ose emrin dhe selinë e personit juridik ndaj të cilit do të kryhet transaksioni.

Të dhënat sipas paragrafit 1 të këtij neni, tatimpaguesi i merr nga dokumentet origjinale ose kopjet e noterizuara të dokumenteve të lëshuara nga RQST ose nga ndonjë tjetër regjistër publik përkatës, të dorëzuara nga klienti ose nga kontrolli i drejtpërdrejtë.

Në qoftë se të dhënat e përshkruara nuk mund të merren siç përcaktohet në paragrafin 2 të këtij neni, të dhënat që mungojnë merren nga dokumentet identifikuese origjinale ose kopjet e noterizuara të tyre, si dhe nga dokumente të tjera të biznesit të dorëzuara nga klienti ose nga deklarata me shkrim e përfaqësuesit ose personit të autorizuar.

Dokumentacioni sipas paragrafëve. 1, 2 dhe 3 të këtij neni nuk duhet të jetë lëshuar brenda 3 muajve të fundit.

Kufizimet në biznesin me klientin

Neni 31

Tatimpaguesi nuk duhet të hapë ose mbajë llogari anonime për llogari të klientit, librezë kursimesh në kod ose bartësit, ose të ofrojë një shërbim tjetër (produkt bankar) i cili, në mënyrë direkte ose indirekte, mundëson fshehjen e identitetit të klientit.

Ndalimi i biznesit me bankat "guaskë"

Neni 32

Tatimpaguesi nuk duhet krijojë marrëdhënie korrespondenti me banka të cilat operojnë ose mund të operojnë si banka "guaskë" ose me institucione të tjera të ngjashme të njohura si institucione që lejojnë përdorimin e llogarive të tyre nga banka "guaskë".

7. Detyrimi për të informuar

Neni 33

Tatimpaguesi duhet t'i japë organit administrativ kompetent të dhënat sipas nenit 71 pikat 1, 2, 3, 4, 5, 9, 10, 11 dhe 12 të këtij ligji për çdo transaksion të kryer me para në dorë në një vlerë prej të paktën 15 000 euro, menjëherë, jo më vonë se tre ditë pune, pas datës së kryerjes së transaksionit.

Tatimpaguesi i përcjell pa vonesë organit administrativ kompetent të dhënat sipas nenit 71 të këtij ligji në rastet kur, në lidhje me transaksionet (pavarësisht nga vlera dhe lloji i tyre) ose klientin, ka dyshime të arsyeshme për pastrim parash ose financim të terrorizmit, përpara kryerjes së transaksionit, dhe cilëson afatin në të cilin duhet të kryhet transaksioni. Njoftimi mund të bëhet me telefon, por duhet t'i përcillet organit administrativ kompetent edhe me shkrim, jo më vonë se një ditë pune pas datës së njoftimit.

Tatimpaguesi duhet t'i dërgojë organit administrativ kompetent të dhënat sipas nenit 71 të këtij ligji edhe pas kryerjes së transaksionit, në rastet kur ekzistojnë dyshime të arsyeshme se transaksioni (pavarësisht nga shuma dhe lloji i tij) ose klienti lidhet me pastrim parash ose financim të terrorizmit.

Në rastet kur një transaksion konsiderohet se përfaqëson pastrim parash ose financim të terrorizmit dhe nuk është e mundur që të pezullohet, ose kur ekziston mundësia që të pengojë përpjekjet për monitorimin e klientit të përfshirë në aktivitete që dyshohet se lidhen me pastrim parash ose financim të terrorizmit, tatimpaguesit duhet të njoftojnë menjëherë organin administrativ kompetent.

Detyrimi sipas paragrafit 2 të këtij neni zbatohet edhe për transaksionet e deklaruara, pavarësisht nëse ekzekutohen apo jo më më pas.

Mënyra dhe kushtet e dërgimit të të dhënave sipas paragrafëve 1 deri në 5 të këtij neni përcaktohen hollësisht nga Ministria.

Transaksionet e pazakonta

Neni 33a

Tatimpaguesi ka detyrimin që të analizojë të gjitha transaksionet e mëdha të pazakonta me qëllim të paqartë ekonomik ose juridik.

Rezultatet e analizës sipas paragrafit 1 të këtij neni, tatimpaguesi i evidenton me shkrim.

Tatimpaguesi, me anë të një akti të brendshëm, përcakton kriteret për njohjen e transaksioneve të pazakonta.

Udhëzimet për transaksionet që konsiderohen të pazakonta përcaktohen nga Ministria, bazuar në bazat profesionale të organit administrativ kompetent.

8. Zbatimi i masave për zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në njësitë e biznesit dhe shoqëritë me pronësinë më të madhe në shtetet e huaja

Neni 34

Tatimpaguesi duhet të garantojë që masat për zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të parashikuara në këtë ligj të zbatohen në të njëjtën masë si nga njësitë e biznesit, edhe nga shoqëritë e zotëruara kryesisht nga tatimpaguesi me seli në një shtet tjetër, në qoftë se është përputhje me sistemin juridik të shtetit përkatës.

Në rast se rregulloret e shtetit nuk parashikojnë zbatimin e masave për zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në të njëjtën masë të parashikuar me këtë ligj, tatimpaguesi duhet të njoftojë menjëherë organin shtetëror dhe të marrë masa për eliminimin e rrezikut të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit.

9. Caktimi i personit të autorizuar dhe zëvendësit të tij

Kryerja e detyrave të zbulimit dhe parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Neni 35

Tatimpaguesi duhet të përcaktojë dhe zbatojë rregullat e duhura në lidhje me veprimet me klientin, raportimin, ruajtjen e të dhënave, kontrollin e brendshëm, vlerësimin e rrezikut, menaxhimin dhe komunikimin e rrezikut, me qëllim parandalimin e veprimtarisë së pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Bankat, institucionet krediduese dhe institucionet e tjera financuese duhet të urdhërojnë, zbatojnë dhe kontrollojnë zbatimin e rregullave sipas paragrafit 1 të këtij neni në degët dhe filialet në shtetet e tjera në të cilat ato zotërojnë shumicën e aksioneve.

Tatimpaguesit të cilët kanë më shumë se tre të punësuar caktojnë një person të autorizuar dhe zëvendësin e tij për detyrën e zbulimit dhe parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Tek tatimpaguesit të cilët kanë më pak se katër të punësuar, detyra e zbulimit dhe parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit kryhet nga drejtori ose një person tjetër i ngarkuar.

Në qoftë se tatimpaguesi sipas nenit 4 paragrafi 2 të këtij ligji nuk emëron një person të autorizuar, person i autorizuar konsiderohet përfaqësuesi ligjor ose çdo person tjetër që administron operacionet e tatimpaguesit, pra personi përgjegjës i tatimpaguesit, në përputhje me ligjin.

Kërkesat për personin e autorizuar

Neni 36

Detyrat e personit të autorizuar dhe të zëvendësit të personit të autorizuar sipas nenit 35 të këtij ligji mund të kryhen nga një person që plotëson kushtet e përcaktuara me aktin e përgjithshëm për sistematizimin e vendeve të punës, duke përfshirë:

1) të jetë punësuar në mënyrë të përhershme për kryerjen e veprimeve dhe detyrave të cilat janë në përputhje me aktin për sistematizimin e organizuar, në mënyrë që të mundësojë me cilësi dhe në kohë kryerjen e detyrave të parashikuara me ligj dhe me dispozitat e miratuara në bazë të këtij ligji;
2) të jetë i kualifikuar profesionalisht për kryerjen e detyrave të parandalimit dhe zbulimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe të disponojë kompetenca profesionale për biznesin e tatimpaguesit në fushat në të cilat ekziston rreziku i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
3) të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale për të cilën është parashikuar dënim me burg për një periudhë mbi gjashtë muaj dhe që do ta bënte atë të papërshtatshëm për kryerjen e detyrave të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Detyrimet e personit të autorizuar

Neni 37

Personi i autorizuar sipas nenit 35 të këtij ligji kryen detyrat si vijon:

1) kujdeset për instalimin, vënien në punë dhe zhvillimin e sistemit të zbulimit dhe parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
2) kujdeset për dërgimin rregullisht dhe në kohë të të dhënave te organi administrativ kompetent;
3) inicion dhe merr pjesë në përpunimin dhe modifikimin e procedurave operative dhe në përgatitjen e akteve të brendshme në lidhje me parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit;
4) bashkëpunon në përgatitjen e udhëzimeve për kryerjen e verifikimeve në lidhje me parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
5) shoqëron dhe koordinon aktivitetin e tatimpaguesit në fushën e zbulimit dhe parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
6) bashkëpunon në instalimin dhe zhvillimin e teknologjisë së informacionit për kryerjen e aktiviteteve të zbulimit dhe parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
7) i paraqet organit administrativ kompetent ose drejtuesit, ose një organi tjetër të tatimpaguesit, nisma dhe propozime për promovimin e sistemit të zbulimit dhe parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
8) përgatit programe për kualifikimin profesional dhe trajnimin e punonjësve të tatimpaguesit në fushën e zbulimit dhe parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Personi i autorizuar i jep llogari drejtpërdrejt bordit ose drejtuesit tjetër ose një organit tjetër të tatimpaguesit, ndërsa nga ana funksionale dhe organizative është i pavarur nga hallkave të tjera organizative të tatimpaguesit.

Në rast mungese ose pamundësie për të kryer detyrat e tij, personi i autorizuar zëvendësohet nga personi i caktuar me aktin e përgjithshëm të tatimpaguesit (zëvendësi i personit të autorizuar).

Kushtet e punës për personin e autorizuar

Neni 38

Tatimpaguesi është i detyruar që personit të autorizuar t'i sigurojë në mënyrë të veçantë:

1) lidhje funksionale të hallkave organizative me personin e autorizuar dhe të ndërtojë mënyrën e bashkëpunimit midis njësive organizative dhe detyrimet dhe përgjegjësitë e të punësuarve;
2) kompetencat përkatëse për kryerjen me efikasitet të detyrave sipas nenit 38 paragrafi 1 i këtij ligji;
3) kushtet e duhura materiale dhe kushtet e tjera për punën;
4) mundësi të përshtatshme ambienti dhe teknike, të cilat mundësojnë shkallën e duhur të mbrojtjes së të dhënave konfidenciale dhe informacioneve që administrohen në bazë të këtij ligji;
5) mbështetjen e duhur informative – teknike që mundëson monitorim të përhershëm dhe të besueshëm të aktiviteteve në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
6) trajnime të rregullta profesionale në lidhje me zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
7) zëvendësim për kohën e mungesave në punë.

Autoriteti ekzekutiv në një organizatë është i detyruar që personit të autorizuar t'i sigurojë ndihmë dhe mbështetje në kryerjen e detyrave të përcaktuara me këtë ligj dhe ta njoftojë për faktet me rëndësi për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit.

Tatimpaguesi është i detyruar që organit administrativ kompetent t'i përcjellë të dhënat për emrin personal dhe titullin e vendit të punës të personit të autorizuar dhe të personit që zëvendëson personin e autorizuar në rastin e mungesës ose paaftësisë së tij,si dhe për çdo ndryshim të këtyre të dhënave, t'i përcjellë pa vonesë dhe brenda 15 ditësh pas datës së ndryshimeve të tyre, të njoftojë organin administrativ kompetent.

Përgatitja dhe trajnimi profesional

Neni 39

Tatimpaguesi, avokati, ose noteri është i detyruar që të sigurojë përgatitje dhe trajnim të rregullt profesional për punonjësit që kryejnë detyrat e zbulimit dhe parandalimit të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit.

Tatimpaguesi, avokati, ose noteri është i detyruar që të përgatisë programin e përgatitjes dhe trajnimit profesional të personave sipas paragrafit 1 të këtij neni jo më vonë se fundi i tremujorit të parë të vitit ushtrimor.

10. Kontrolli i brendshëm

Neni 40

Tatimpaguesi garanton kontrollin të brendshëm të rregullt të kryerjes së detyrave të zbulimit dhe parandalimit të pastrimit së parave dhe të financimit të terrorizmit.

Mënyra e punës e personit të autorizuar, kryerja e kontrollit të brendshëm, mbajtja dhe ruajtja e të dhënave, mbajtja e regjistrave dhe trajnimi i punonjësve të tatimpaguesit, avokatit, zyrave të avokatisë dhe shoqërive ortake të avokatisë (në vijim referuar si: Avokat), noterëve, shoqërive të auditimit, autituesve të pavarur ose të personave fizikë që ofrojnë shërbime kontabiliteti ose të ngjashme, rregullohen në mënyrë të detajuar me aktin nënligjor të Ministrisë.

III. DETYRAT DHE DETYRIMET E AVOKATIT DHE NOTERIT

Detyrat dhe detyrimet e avokatit dhe noterit

Neni 41

Në përputhje me këtë ligj, avokati ose noteri zbaton masat për zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në rastin kur:

1) ndihmon në planifikimin dhe ekzekutimin e transaksioneve për një klient, të cilat lidhen me:

- blerjen dhe shitjen e pasurive të paluajtshme ose të shoqërisë tregtare;
- menaxhimin e parave, letrave me vlerë ose të një pasurie tjetër të klientit;
- hapjen dhe administrimin e llogarisë bankare, depozitave të kursimit ose të llogarisë për operacione tregtare në letra me vlerë;
- mbledhjen e fondeve për themelimin, funksionimin ose menaxhimin e shoqërisë tregtare;
- themelimin, funksionimin ose menaxhimin e një institucioni, fondi, shoqërie tregtare ose ndonjë forme tjetër të ngjashme organizimi;

2) kryen, në emër dhe për llogari të klientit, një transaksion financiar ose një transaksion që lidhet me pasuri të paluajtshme.

Verifikimi i klientit

Neni 42

Avokati ose noteri, në kuadrin e verifikimit të klientit në procedurën e përcaktimit të identitetit të tij sipas nenit 9 paragrafi 1 pikat 1 dhe 2 të këtij ligji, merr të dhënat sipas nenit 73 pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 11 të këtij ligji.

Avokati ose noteri, në kuadrin e verifikimit të klientit në procedurën sipas nenit 9 paragrafi 2 të këtij ligji, merr të dhënat sipas paragrafit 73 pikat 1, 2, 3, 4, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të këtij ligji.

Avokati ose noteri, në procedurën e zbatimit të masave për verifikimin e thelluar dhe monitorimin e klientit sipas nenit 9 paragrafi 1 pikat 3 dhe 4 të këtij ligji, merr të dhënat sipas nenit 73 pikat 12, 13 dhe 14 të këtij ligji.

Avokati ose noteri përcakton dhe verifikon identitetin e klientit ose të përfaqësuesit apo personit të tij të autorizuar dhe merr të dhënat sipas neni 73 pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni përmes kontrollit në kartën personale të klientit në prani të tij ose në kopjen origjinale ose të noterizuar të dokumentacionit të lëshuar nga RQST ose një regjistër tjetër përkatës publik, të lëshuar brenda tre muajve të fundit.

Avokati ose noteri konfirmon pronarin e vërtetë të klientit, i cili është person juridik ose një formë tjetër e ngjashme organizimi i personave juridikë të huaj, duke marrë të dhënat sipas nenit 73 pika 4 të këtij ligji përmes kontrollit në kopjen origjinale ose të noterizuar të dokumentacionit të lëshuar nga RQST ose një regjistër tjetër publik, të lëshuar brenda tre muajve të fundit. Në qoftë se të dhënat e përshkruara nuk mund të merren plotësisht regjistri, të dhënat që mungojnë merren nga dokumentet origjinale ose kopjet e noterizuara apo dokumentacione të tjera të biznesit të dorëzuara nga përfaqësuesi i personit juridik ose i një forme tjetër organizimi, ose nga një person tjetër i autorizuar.

Të dhënat sipas nenit 73 të këtij ligji që mungojnë, avokati ose noteri i merr nga dokumentet origjinale ose të noterizuara dhe nga dokumentacione të tjera të biznesit.

Në qoftë se dokumentet e parashikuara nuk mund të merren në mënyrën e përshkruar në paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij neni, të dhënat që mungojnë, përveç të aty të përcaktuara në nenin 73 pikat 12, 13 dhe 14 të këtij ligji, merren direkt nga deklarata me shkrim e klientit.

Raportimi për klientët dhe transaksionet, për të cilët ekzistojnë arsye për të dyshuar për pastrim parash dhe financim të terrorizmit

Neni 43

Në qoftë se avokati ose noteri, gjatë kryerjes së detyrave sipas nenit 41 pika 2 të këtij ligji, konfirmon se ka dyshime të arsyeshme se transaksioni ose personi përfshin pastrim parash ose financim të terrorizmit, ai duhet të njoftojë organin administrativ kompetent përpara kryerjes së transaksionit, duke cilësuar në njoftim afatin në të cilin duhet të kryhet transaksioni. Njoftimi mund të bëhet me telefon, por duhet t'i përcillet organit administrativ kompetent edhe me shkrim, jo më vonë se një ditë pune pas datës së njoftimit.

Detyrimi sipas paragrafit 1 të këtij neni zbatohet edhe për transaksionet e planifikuara, pavarësisht nëse ato ekzekutohen apo jo më pas.

Në qoftë se avokati, zyra e avokatisë ose noteri, në rastet sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, për shkak të natyrës së transaksionit ose për shkaqe të tjera të justifikuara, nuk mund të dërgojë njoftimin, ai duhet t'i dërgojë organit administrativ kompetent të dhënat sapo t'i krijohet mundësia, ose sapo të konstatojë se ekzistojnë arsye për të dyshuar për pastrim parash ose financim të

terrorizmit, si dhe do të përshkruajë arsyet për shkak të të cilave nuk ka vepruar në mënyrën e parashikuar në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni.

Në rastet kur një klient kërkon këshilla rreth pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, avokati ose noteri duhet të njoftojë pa vonesë organin administrativ kompetent.

Noteri është i detyruar që një herë në javë t'i dërgojë organit administrativ kompetent kopjet e noterizuara të kontratave të shitjes që lidhen me tregtinë e pasurive të paluajtshme, vlera e të cilave i kalon 15 000 Euro.

Avokati, zyra e avokatisë ose noteri, duhet t'i dërgojë organit administrativ kompetent të dhënat sipas nenit 73 të këtij ligji, në mënyrën e përcaktuar nga akti nënligjor i Ministrisë.

Përjashtime

Neni 44

Duke bërë përjashtim nga neni 43 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji, avokati nuk është i detyruar që t'i dërgojë organit administrativ kompetent të dhënat që ka marrë nga klienti ose për klientin gjatë përcaktimit të pozicionit të tij juridik ose përfaqësimit në një proces gjyqësor që përfshin këshillimin mbi propozimin ose shmangien.

Me kërkesë të organit administrativ kompetent për dërgimin e të dhënave sipas nenit 49 paragrafët 1 dhe 2 të këtij ligji, avokati paraqet me shkrim arsyet për shkak të të cilave nuk ka vepruar në përputhje me kërkesën, pa vonesë dhe jo më vonë se 15 ditë pas datës së marrjes së kërkesës,.

Avokati duhet t'i raportojë transaksionet kesh sipas nenit 33 paragrafi 1 të këtij ligji vetëm nëse ka arsye për të dyshuar se transaksioni ose klienti është i përfshirë në pastrim parash ose financim të terrorizmit.

IV. LISTA E TREGUESVE PËR IDENTIFIKIMIN E KLIENTËVE DHE TRANSAKSIONEVE TË DYSHIMTA

Përdorimi i listës së treguesve

Neni 45

Tatimpaguesi, avokati ose noteri, gjatë përcaktimit të bazave të dyshimit për pastrim parash ose financim të terrorizmit dhe rrethanat e tjera lidhur me dyshimin, duhet të përdorë listën e treguesve për identifikimin e klientëve dhe të transaksioneve të dyshimta.

Lista e treguesve sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të gjendet në ambientet e punës së tatimpaguesit, avokatit ose noterit.

Përcaktimi i listës së treguesve

Neni 46

Lista e treguesve për identifikimin e klientëve dhe të transaksioneve të dyshimta përcaktohet nga Ministria, bazuar në bazat shkencore të përgatitura nga organi administrativ kompetent në bashkëpunim me organet kompetente.

V. ORGANI ADMINISTRATIV KOMPETENT

Punët dhe detyrat e organit administrativ

Neni 47

Punët administrative që lidhen me zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, të parashikuara nga ky ligj dhe nga dispozita të tjera, kryhen nga organi administrativ kompetent.

Dërgimi i të dhënave, informacioneve dhe dokumentacionit organit administrativ kompetent sipas paragrafit 1 të këtij neni në bazë të këtij ligji, kryhet kundrejt asnjë kompensimi.

Dërgimi i të dhënave pas kërkesës

Neni 48

Nëse organi administrativ kompetent vlerëson se ka baza për të dyshuar se bëhet fjalë për pastrim parash ose financim të terrorizmit, ai mund të kërkojë që tatimpaguesi të dërgojë në veçanti të dhënat:

1) nga regjistri i klientëve dhe transaksioneve i mbajtur në përputhje me nenin 70 të këtij ligji;
2) për gjendjen e mjeteve financiare dhe pasurive të tjera të klientit tek tatimpaguesi;
3) për qarkullimin e mjeteve financiare dhe të pasurive të klientit tek tatimpaguesi;
4) për marrëdhëniet e biznesit të vendosur me tatimpaguesin;
5) informacioneve që tatimpaguesi i ka marrë ose administron në bazë të ligjit.

Në kërkesën sipas paragrafit 1 të këtij neni, organi administrativ kompetent duhet të cilësojë të dhënat që duhen dërguar, bazat juridike, qëllimin e mbledhjes së të dhënave dhe afatin për dërgimin e tyre.

Organi administrativ kompetent mund të kërkojë dërgimin e të dhënave sipas paragrafit 1 të këtij neni edhe për persona për të cilët mund të arrihet në përfundimin se kanë bashkëpunuar ose kanë marrë pjesë në transaksionet ose në operacionet e personave për të cilat ka baza dyshimi se përfshijnë pastrim parash ose financim të terrorizmit.

Me kërkesë të organit administrativ kompetent, tatimpaguesi, në rastet e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, duhet të dërgojë dokumentacionin që disponon.

Organi administrativ kompetent mund t'i kërkojë tatimpaguesit që të dërgojë të dhënat, informacionet dhe dokumentacionin në lidhje me realizimin e detyrave në përputhje me këtë ligj, si dhe të dhëna të tjera të nevojshme për monitorimin e përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj.

Të dhënat, informacionet dhe dokumentacionin sipas paragrafëve 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij neni, tatimpaguesi duhet t'ia përcjellë organit administrativ kompetent menjëherë dhe jo më vonë se tetë ditë pas marrjes së kërkesës.

Nëse organi administrativ kompetent bën kërkesë urgjente për dërgimin e të dhënave, informacionit dhe dokumenteve të përcaktuara në paragrafët 1 dhe 5 të këtij neni të cilësuar si urgjente, tatimpaguesi i dërgon ato, brenda 24 orësh.

Për shkak të volumit të dokumentacionit të kërkuar ose për arsye të tjera të justifikuara dhe pas kërkesës së argumentuar të tatimpaguesit, organi administrativ kompetent mund ta shtyjë afatin e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni dhe të kryejë verifikimin e të dhënave tek tatimpaguesi.

Kërkesa për dërgimin e të dhënave mbi transaksionet dhe personat e dyshimtë nga avokati ose noteri

Neni 49

Në qoftë se organi administrativ kompetent vlerëson se ka baza të arsyeshme për të dyshuar për pastrim parash ose financim të terrorizmit, ai mund t'i kërkojë avokatit ose noterit që të dërgojë të dhënat sipas nenit 48 të këtij ligji që nevojiten për zbulimin e pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit.

Në kërkesë, organi kompetent cilëson të dhënat, bazën juridike, qëllimin e kërkimit të tyre, si dhe afatin për dërgimin e tyre.

Organi administrativ kompetent mund të kërkojë dërgimin e të dhënave sipas paragrafit 1 të këtij neni edhe për personat për të cilët mund të vlerësohet se kanë bashkëpunuar ose kanë marrë pjesë në transaksionet ose operacionet e personave për të cilët ka arsye për të dyshuar për pastrim parash ose financim të terrorizmit.

Organi administrativ kompetent mund t'i kërkojë avokatit ose noterit të dhëna, informacione dhe dokumente në lidhje me kryerjen e veprimeve në përputhje me këtë ligj, si dhe të dhëna të tjera të nevojshme për monitorimin e përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj.

Nga këndvështrimi i afateve dhe mënyrës së dërgimit të të dhënave sipas paragrafëve 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni, zbatohen dispozitat e nenit 48 paragrafët 6 dhe 7 të këtij ligji.

Kërkesa ndaj organit shtetëror ose mbajtësit të kompetencave publike për dorëzimin e të dhënave mbi transaksionet ose personat e dyshimtë

Neni 50

Nëse organi administrativ kompetent vlerëson se ka baza për të dyshuar për pastrim parash ose financim të terrorizmit, ai mund t'u kërkojë organeve shtetërore ose mbajtësit të kompetencave publike që të dërgojnë të dhënat, informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm për zbulimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit.

Organi administrativ kompetent duhet të cilësojë në kërkesë të dhënat që duhen dërguar, bazën juridike, qëllimin e kërkimit dhe afatin për dërgimin e tyre.

Organi administrativ kompetent mund të kërkojë dërgimin e të dhënave sipas paragrafit 1 të këtij neni edhe për personat për të cilët mund të vlerësohet se kanë bashkëpunuar ose kanë marrë pjesë në transaksionet ose në operacionet e personave për të cilët ka baza për të dyshuar se bëhet fjalë për pastrim parash ose financim të terrorizmit.

Organet shtetërore dhe mbajtësit e kompetencave publike ia dërgojnë organit administrativ kompetent të dhënat, informacionet dhe dokumentacionin e kërkuar, pa vonesë dhe jo më vonë se tetë ditë nga marrja e kërkesës, ose i mundësojnë, pa kompensim, akses elektronik të drejtpërdrejtë në të dhënat dhe informacionet e cilësuara në kërkesë.

Urdhri për pezullimin e përkohshëm të transaksionit

Neni 51

Organi administrativ kompetent mund ta pezullojë përkohësisht transaksionin, por jo më shumë se 72 orë, në qoftë se vlerëson se ka baza për të dyshuar për pastrim parash ose financim të terrorizmit, rast në të cilin duhet të njoftojë pa vonesë organet kompetente.

Në rast se afati sipas paragrafit 1 të këtij neni bie në ditë pushimi, organi administrativ kompetent mund ta nxjerrë një urdhër për të shtyrë afatin me 48 orë.

Në rast se për shkak të natyrës dhe mënyrës së kryerjes së transaksionit ose për shkak të rrethanave të tjera në të cilat kryhet, afati i transaksionit nuk mund të shtyhet, me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, urdhri mund të jepet verbalisht.

Personi përgjegjës i tatimpaguesit mban shënim marrjen e urdhrit me verbal sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Urdhrin e dhënë verbalisht, organi administrativ kompetent duhet ta dërgojë pa vonesë edhe me.

Pas marrjes së njoftimit për pezullim të transaksionit, organet administrative kompetente sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet veprojnë menjëherë, jo më vonë se 72 orë nga pezullimi i përkohshëm i transaksionit,në përputhje me kompetencat e tyre dhe duhet të njoftojnë menjëherë organin administrativ kompetent.

Përfundimi i masave të pezullimit të përkohshëm të transaksionit

Neni 52

Në rast se, brenda 72 orësh nga dhënia e urdhrit për pezullimin e përkohshëm të transaksionit, organi kompetent vlerëson se ka baza për të dyshuar për pastrim parash ose financim të terrorizmit, ai duhet të njoftojë menjëherë organet përkatëse dhe tatimpaguesin.

Në qoftë se organi kompetent, brenda 72 orësh, nuk merr masat sipas nenit 51 paragrafi 5 të këtij ligji, tatimpaguesi mund ta kryejnë menjëherë transaksionin.

Kërkesa për monitorimin e vazhdueshëm të operacioneve financiare të klientit

Neni 53

Organi administrativ kompetent mund t'i kërkojë tatimpaguesit me shkrim që të monitorojë në vazhdimësi operacionet financiare të klientëve, për të cilët ka arsye për të dyshuar se përfshijnë pastrim parash ose financim të terrorizmit, ose të një personi i cili dyshohet se ka bashkëpunuar ose ka marrë pjesë në transaksione ose operacione për të cilat ka arsye për të dyshuar se lidhen me pastrim parash ose financim të terrorizmit dhe cakton afatin brenda të cilit duhet të informojë dhe të dërgojë të dhënat e kërkuara.

Të dhënat sipas paragrafit 1 të këtij neni, tatimpaguesi ia dërgon ose raporton organit

administrativ kompetent përpara kryerjes së transaksionit ose lidhjes së biznesit dhe në njoftim të cilëson afatin në të cilin duhet të kryhet transaksioni ose operacioni.

Në qoftë se për shkak të natyrës së transaksionit ose të operacionit, ose për arsye të tjera të justifikuara, tatimpaguesi nuk është në gjendje që të veprojë në mënyrën e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, ai duhet t'ia raportojë të dhënat organit administrativ kompetent sapo t'i krijohet mundësia dhe jo më vonë se një ditë pune pas datës së kryerjes së transaksionit ose të operacionit tregtar. Në raporti, ai duhet të paraqesë arsyet për shkak të të cilave nuk ka vepruar në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni.

Monitorimi i vazhdueshëm i transaksioneve sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të zgjasë maksimumi tre muaj, ndërsa në rastin kur ka baza për të dyshuar se bëhet fjalë për pastrim parash ose financim të terrorizmit, kjo periudhë mund të zgjatet maksimumi me tre muaj nga data e dorëzimit të kërkesës sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Mbledhja e të dhënave në bazë të kërkesës

Neni 54

Në qoftë se për një transaksion ose person të caktuar ka baza për të dyshuar se bëhet fjalë për pastrim parash ose financim të terrorizmit, organi administrativ kompetent, në bazë të kërkesës me shkrim dhe të mbështetur nga gjykata, prokurori i shtetit, organ administrativ kompetent për çështjet e policisë, organi tatimor kompetent, organi doganor kompetent, organi kompetent për luftën kundër korrupsionit dhe ndonjë organ tjetër shtetëror kompetent, nis procedurën e mbledhjes dhe analizës së të dhënave, informacioneve dhe dokumenteve, me qëllim zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

Kërkesa me shkrim sipas paragrafit 1 të këtij neni përmban në mënyrë të veçantë përshkrimin e arsyeve të dyshimit për pastrim parash ose financim të terrorizmit, si dhe të dhënat vijuese:

1) emrin dhe mbiemrin, datëlindjen dhe vendlindjen dhe vendbanimin e përhershëm të personit fizik, ose emrin, adresën e personit juridik me të cilin lidhen dyshimet për pastrim parash ose financim të terrorizmit;
2) të dhënat e transaksionit në lidhje me të cilin ka shkaqe për të dyshuar për pastrim parash ose financim të terrorizmit (objekti, vlera, valuta, data ose periudha e kryerjes së transaksionit ose të dhëna të tjera rreth transaksionit).

Në qoftë se kërkesa me shkrim sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk është e argumentuar dhe nuk përmban të dhënat sipas paragrafit 2 të këtij neni, organi administrativ kompetent ia kthen parashtruesit të kërkesës për ta plotësuar.

Në rast se kërkesa me shkrim nuk plotësohet brenda tetë ditësh, ose nëse është përsëri e paargumentuar dhe nuk përmban të dhënat sipas paragrafit 2 të këtij neni, organi administrativ kompetent njofton aplikantin me shkrim se kërkesa në fjalë nuk i plotëson kushtet për nisjen e procedurës së mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave, duke cilësuar arsyet e mosmarrjes në konsideratë të kërkesës dhe të mosnisjes së procedurës.

Raportimi i transaksioneve të dyshimta

Neni 55

Në qoftë se organi administrativ kompetent, mbi bazën e të dhënave, informacioneve dhe dokumenteve të marra në përputhje me këtë ligj, vlerëson se në lidhje me ndonjë transaksion ose person ka dyshim për pastrim parash ose financim të terrorizmit, ai njofton për dyshimin organin kompetent, me anë të dokumentacionit përkatës.

Organi administrativ kompetent, në njoftimin sipas paragrafit 1 të këtij paragrafi nuk duhet të japë të dhëna për tatimpaguesin dhe të punësuarin në organizatën që ka raportuar të dhënat, me përjashtim të rasteve kur ka baza për të dyshuar se tatimpaguesi ose punonjësi i tatimpaguesit ka kryer veprën penale të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, ose nëse të dhënat janë të nevojshme për përcaktimin e fakteve në një proces penal dhe në qoftë se transferimi i tyre kërkohet me shkrim nga gjykata kompetente.

Informacionet për vepra të tjera penale

Neni 56

Në qoftë se organi administrativ kompetent, mbi bazën e të dhënave, informacioneve dhe dokumenteve të marra në përputhje me këtë ligj, vlerëson se në lidhje me transaksionin ose personin ka baza për të dyshuar se janë kryer vepra të tjera penale të cilat janë proceduar sipas procedurave zyrtare, ai u dërgon organeve kompetente një njoftim me shkrim.

Komentet në lidhje me informacionin

Neni 57

Pas marrjes dhe analizës së të dhënave, informacioneve dhe dokumentacionit në lidhje me personin ose transaksionin për të cilin janë dhënë arsye dyshimi se bëhet fjalë për pastrim parash ose financim të terrorizmit ose janë konfirmuar fakte të cilat janë konfirmuar fakte se kanë përfshirë ose mund të jenë të përfshijnë pastrim parash ose financim të terrorizmit, organi administrativ kompetent njofton me shkrim tatimpaguesin ose parashtruesin e kërkesës, me përjashtim të rastit kur vlerëson se njoftimi mund të shkaktojë pasoja të dëmshme për ecurinë dhe rezultatin e procesit.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Neni 58

Para dërgimit të të dhënave personale organit kompetent për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në një shtet të huaj, organi administrativ kompetent verifikon nëse organi, të cilit do t'i përcjellë të dhënat e kërkuara, disponon sistemin e duhur për mbrojtjen e të dhënave personale dhe nëse të dhënat do të përdoren vetëm për qëllimin në fjalë, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga marrëveshje ndërkombëtare.

Organi administrativ kompetent mund të lidhë marrëveshje për shkëmbimin e të dhënave financiare dhe informative, informacioneve dhe dokumentacionit me organe kompetente të shteteve të huaja dhe me organizatat ndërkombëtare, në përputhje me marrëveshjen e lidhur ndërkombëtare.

Kërkesa ndaj organit kompetent të shtetit të huaj për dërgimin e të dhënave

Neni 59

Organi administrativ kompetent, në kuadrin e kompetencave të tij, mund t'i kërkojë organit kompetent të një shteti tjetër të dhëna, informacione dhe dokumente të nevojshme për zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit.

Të dhënat, informacionet dhe dokumentet e marra në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, organi administrativ kompetent mund t'i përdorë vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë ligj dhe pa miratimin paraprak të organeve të shtetit të huaj nga i cili janë marrë këto të dhëna, nuk duhet t'ia japë ose paraqesë një organi tjetër, personi juridik ose fizik, apo t'i përdorë ato për qëllime të cilat nuk janë në përputhje me kushtet dhe kufizimet e përcaktuara nga organi të cilit i është drejtuar kërkesa.

Dërgimi i të dhënave dhe informacioneve me kërkesë nga një organ administrativ kompetent i një shteti tjetër

Neni 60

Informacionet dhe dokumentet për personat ose transaksionet për të cilat ka dyshime se lidhen me pastrim parash ose financim të terrorizmit, organi administrativ kompetent mund t'i dërgojë me kërkesë të organit kompetent për zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të një shteti tjetër, sipas kushteve të reciprocitetit.

Organi administrativ kompetent nuk është i detyruar që të veprojë në përputhje me kërkesën e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, në rast se:

1) në bazë të fakteve dhe rrethanave të paraqitura në kërkesë vlerëson se nuk janë dhënë shkaqe të mjaftueshme për të dyshuar se bëhet fjalë për pastrim parash dhe financim të terrorizmit.

2) dërgimi i të dhënave kërcënon ose do të kërcënonte ecurinë e një procesi gjyqësor në Malin e Zi ose do të dëmtonte në një mënyrë tjetër interesat e Malit të Zi.

Organi administrativ kompetent njofton me shkrim organin që ka dërguar kërkesën në lidhje me refuzimin e kësaj të fundit, duke specifikuar arsyet e refuzimit.

Organi administrativ kompetent mund të përcaktojë kushte dhe kufizime në përdorimin e të dhënave sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Dërgimi i të dhënave organit kompetent të një shteti të tjetër me vetiniciativë

Neni 61

Të dhënat, dokumentacionin dhe informacionet për klientët ose transaksionet, për të cilat ka arsye për të dyshuar se bëhet fjalë për pastrim parash ose financim të terrorizmit, të marra ose të përpunuara në përputhje me këtë ligj, organi administrativ kompetent mund t'ia dërgojë, me iniciativën e tij, organit kompetent për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit të një shtetit të huaj, sipas kushtit të reciprocitetit.

Organi administrativ kompetent, gjatë dërgimit të të dhënave me iniciativën e tij, mund të përcaktojë kushtet dhe kufizimet sipas të cilave organi kompetent për zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit i një shteti të huaj mund të përdorë të dhënat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

Pezullimi i përkohshëm i transaksioneve me kërkesë të organeve kompetente të huaja

Neni 62

Organi administrativ kompetent, në përputhje me këtë ligji, sipas kushtit të reciprocitetit dhe me kërkesë me shkrim nga organi kompetent i një shteti të huaj, mund ta pezullojë transaksionin përkohësisht, maksimumi për 72 orë, me anë të një urdhri me shkrim.

Për urdhrin sipas paragrafit 1 të këtij neni, organi administrativ kompetent njofton organet kompetente.

Organi administrativ kompetent mund ta refuzojë kërkesën e organit sipas paragrafit 1 të këtij neni në qoftë se në bazë të fakteve dhe rrethanave të pasqyruara në kërkesë, vlerëson se nuk janë paraqitur shkaqe të mjaftueshme për dyshimin për pastrim parash ose financim të terrorizmit, duke cilësuar shkaqet për refuzimin e saj.

Kërkesa ndaj organit kompetent për pezullim të përkohshëm të transaksionit

Neni 63

Organi administrativ kompetent, në kuadrin e kompetencave tij në fushën e zbulimit dhe parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, mund t'u paraqesë organeve të shteteve të huaja kompetente për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, një kërkesë me shkrim për pezullim të përkohshëm të transaksionit, në rast se vlerëson se ekzistojnë arsye të mjaftueshme për të dyshuar se bëhet fjalë për pastrim parash ose financim të terrorizmit.

Kompetencat dhe detyrat e organit administrativ kompetent

Neni 64

Organi administrativ kompetent është i autorizuar ka kompetencat e mëposhtme:

1) ndërmerr iniciativa për ndryshimin dhe plotësimin e akteve nënligjore për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
2) përgatit dhe unifikon listën e treguesve për diktimin e klientëve dhe të transaksioneve për të cilat ka dyshime se lidhen me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit dhe ia dërgon atë personave që kanë detyrimet e përcaktuara në këtë ligj;
3) merr pjesë në trajnime ose në përgatitjen profesionale të personave të autorizuar të punësuar nga tatimpaguesit dhe organet shtetërore kompetente;

3a) publikon në faqen e tij të internetit listën e vendeve që zbatojnë standarde ndërkombëtare

në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, të cilat janë në nivelin e standardeve të BE-së ose në një nivel më të lartë;

3b) publikon në faqen e tij të internetit listën e personave vendas të ekspozuar politikisht;

4) publikon në faqen e tij të internetit listën e vendeve që zbatojnë standardet për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit;

5) përgatit dhe të publikon rekomandime ose udhëzime për zbatim të unifikuar të këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në bazë të tij, tek tatimpaguesit;

6) raporton, të paktën një herë në vit, të dhënat statistikore në lidhje me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit (numrin e transaksioneve të dyshimta të dërguar organit kompetent, numrin e rasteve të kërkimit, numrin e personave të ndjekur penalisht, numrin e personave të dënuar për veprën penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, të dhënat në lidhje me numrin e pasurive të ngrira, të sekuestruara ose të konfiskuara dhe informon publikun në mënyrën e duhur mbi format e ndryshme të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit.

Organi administrativ kompetent ka detyrimin që, me kërkesë të gjykatës ose të prokurorit të shtetit, të dërgojë të dhënat e disponueshme, informacionet ose dokumentacionin nga regjistri i personave dhe transaksioneve, përveç të dhënave të marra në bazë të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe për të cilat nuk ka marrë miratimin e organit kompetent të shtetit të huaj, të cilat i nevojiten gjykatës dhe prokurorisë gjatë zhvillimit të procesit.

Raportimi ndaj qeverisë

Neni 65

Organi administrativ kompetent i dërgon qeverisë një raport mbi situatën dhe punën e tij në fushën e menaxhimit, të paktën një herë në vit.

VI. DETYRIMET E ORGANEVE SHTETËRORE

Organi administrativ për çështjet doganore

Neni 66

Organi administrativ kompetent për çështjet doganore ka detyrimin që t'i dërgojë organit administrativ kompetent të dhënat ose t'i mundësojë akses elektronik në çdo transferim nëpërmjet kufirit shtetëror të parave, çeqeve, letrave me vlerë ndaj dhuruesve, metaleve ose gurëve të çmuar, vlera ose shuma e të cilave është 10 000 euro ose më shumë, brenda tre ditësh nga data e transportit të tyre.

Organi administrativ kompetent për çështjet doganore i dërgon organit administrativ të dhënat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni në lidhje me transportin ose përpjekjen për transport të parave, çeqeve, letrave me vlerë, metaleve ose gurëve të çmuar, me vlerë 10 000 euro ose më shumë, në qoftë se ka arsye për të dyshuar se personi në fjalë është përfshirë në pastrim parash ose financim të terrorizmit.

Shoqëritë e këmbimit valutor dhe të klerimit

Neni 67

Shoqëritë e këmbimit valutor dhe të klerimit duhet të njoftojnë menjëherë me shkrim organin administrativ kompetent në rast se gjatë kryerjes së operacioneve të fushës së tyre zbulojnë fakte që evidentojnë lidhjen e mundshme të tyre me pastrim parash ose financim të terrorizmit.

Personat juridikë sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të dërgojnë të dhënat, informacionet ose dokumentet që evidentojnë lidhje të mundshme me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, pas kërkesës nga organi administrativ kompetent dhe në përputhje me ligjin.

Në kuadrin e afateve dhe mënyrës së dërgimit të të dhënave sipas paragrafit 2 të këtij neni, zbatohen dispozitat e nenit 48 paragrafët 6 dhe 7 të këtij ligji.

Gjykatat, prokurori i shtetit dhe organet e tjera shtetërore

Neni 68

Për qëllime të mbajtjes së një regjistri të unifikuar lidhur me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, gjykatat kompetente, prokurori i shtetit dhe organet e tjera shtetërore duhet t'i dërgojnë organit administrativ kompetent të dhëna rreth shkeljeve dhe veprave penale që lidhen me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Organet administrative kompetente të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, duhet t'i dërgojnë organit administrativ kompetent, në mënyrë të rregullt dhe pas kërkesës, të dhënat e mëposhtme:

1) datën e depozitimit të denoncimit për kryerjen e një vepre penale;
2) emrin, datëlindjen dhe adresën e personit ose emrin e shoqërisë, adresën dhe selinë e personit të denoncuar;
3) natyrën e veprës penale dhe vendin, kohën dhe mënyrën e kryerjes së veprimeve të cilat kanë elemente të veprës penale;
4) vepra penale të mëparshme dhe vendin, kohën dhe mënyrën e kryerjes së veprave që kanë elementet e një vepre penale të mëparshme.

Prokurori i shtetit dhe gjykatat kompetente duhet t'i përcjellin organit administrativ kompetent, të paktën një herë në vit, të dhënat e mëposhtme:

1) emrin, datëlindjen dhe adresën e personit ose emrin e shoqërisë, adresën dhe selinë e personit të denoncuar ose të personit që ka bërë kërkesë për mbrojtje gjyqësore në kuadrin e procedurës për kundërvajtje sipas këtij ligji;
2) fazën proceduriale dhe vendimin përfundimtar;
3) elementet ligjore të natyrës së veprës penale ose të shkeljes;
4) emrin, datëlindjen dhe adresën e personit ose emrin e shoqërisë dhe selinë e personit për të cilin është caktuar masa e bllokimit të përkohshëm ose sekuestrimit të përkohshëm të;
5) datën e dhënies dhe kohëzgjatjen e urdhrit për bllokim të përkohshëm ose sekuestrim të përkohshëm të aseteve;
6) vlerën e aseteve ose vlerën e pasurisë me të cilën lidhet urdhri për masën e përkohshme të bllokimit ose sekuestrimit të përkohshëm të aseteve;
7) datën e lëshimit të urdhrit për sekuestrim të mjeteve monetare ose të pasurisë;
8) vlerën e mjeteve të konfiskuara ose vlerën e pasurisë së sekuestruar.

Informimi mbi vëzhgimet dhe masat e marra

Neni 69

Organet kompetente informojnë organin administrativ kompetent, një herë në vit dhe jo më vonë se fundi i janarit të vitit aktual, mbi vëzhgimet dhe masat e marra prej tij gjatë vitit pararendës në lidhje me transaksionet e dyshimta për pastrim parash ose financim të terrorizmit, në përputhje me këtë ligj.

VII. REGJISTRAT, RUAJTJA E DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE

1. Administrimi dhe përmbajtja e regjistrave

Regjistrat që mbahen nga tatimpaguesi

Neni 70

Tatimpaguesit kanë për detyrë që të mbajnë:

1) regjistrin e të dhënave rreth klientëve, marrëdhënieve të punës dhe transaksioneve sipas nenit 9 të këtij ligji;
2) regjistrin e të dhënave sipas paragrafit 33 të këtij ligji.

Përmbajtja e regjistrave të tatimpaguesit

Neni 71

Në regjistrat e përmendur në nenin 70 të këtij ligji, mbahen dhe përpunohen të dhënat e

mëposhtme:

1) emrin, adresën, selinë dhe numrin identifikues të personit juridik që vendos marrëdhënie pune ose kryen transaksione, ose të personit juridik për llogari të të cilit vendoset marrëdhënia e punës ose kryhet transaksioni;
2) emrin, adresën e banimit ose të qëndrimit, datëlindjen dhe vendlindjen dhe numrin tatimor (NIPT) të përfaqësuesit ose të personit të autorizuar që vendos marrëdhënie pune ose kryen transaksione për personin juridik ose për një person tjetër të themeluar sipas ligjit, numrin, llojin dhe emrin e organit që ka lëshuar dokumentin e identifikimit personal;
3) emrin, adresën e banimit ose të qëndrimit, datëlindjen dhe vendlindjen dhe numrin tatimor (NIPT) të personit të autorizuar që kërkon ose kryen transaksione për një klient, si dhe numrin, llojin dhe titullin e organit që ka lëshuar dokumentin personal;
4) emrin, adresën e banimit ose e qëndrimit, datëlindjen, vendlindjen dhe numrin tatimor të personit fizik ose të përfaqësuesit të tij, sipërmarrësit ose personit fizik që kryen aktivitetin që vendos marrëdhënien e biznesit ose kryen transaksionin, ose të personit fizik për të cilin vendoset marrëdhënia e biznesit ose kryhet transaksioni, si dhe numrin, llojin dhe emrin e organit që ka lëshuar dokumentin identifikues personal;
5) emrin, adresën dhe numrin identifikues, në qoftë se është caktuar, të sipërmarrësit ose të personit fizik që kryen aktivitetin;
6) emrin personal, adresën e banimit ose të qëndrimit, datëlindjen dhe vendlindjen e personit fizik që futet në kazino ose që ka akses në kasaforta;
7) qëllimin ose natyrën e presupozuar e marrëdhënies së biznesit, duke përfshirë informacionin për aktivitetin e klientit;
8) datën e vendosjes së marrëdhënies së biznesit ose datën dhe orën e aksesit në kazino ose në kasafortë;
9) datën dhe orën e kryerjes së transaksionit;
10) vlerën e transaksionit dhe valutën në të cilin është kryer ai;
11) qëllimin e transaksionit dhe emrin personal dhe vendbanimin ose vendqëndrimin ose shoqërinë dhe selinë e personit të cilit i destinohet transaksioni;
12) mënyrën e kryerjes së transaksionit;
13) të dhëna për burimin e pasurisë dhe të mjeteve financiare, të cilat janë ose do të jenë objekt i marrëdhënieve të biznesit ose transaksionit;
14) shkaqet e dyshimit për pastrim parash ose financim të terrorizmit;
15) emrin personal, adresën e banimit ose të qëndrimit dhe datëlindjen dhe vendlindjen e pronarit real të subjektit juridik ose,në rastin e parashikuar në nenin 19 paragrafi 3 pika 2 të këtij ligji, të dhëna për kategorinë e personave që kanë interes në themelimin dhe funksionimin e subjektit juridik ose të një personi juridik të ngjashëm të huaj;
16) emrin e personave të tjerë ligjorë dhe emrin personal, adresën e banimit ose të qëndrimit, datëlindjen, vendlindjen dhe numrin tatimor (NIPT) të anëtarit.

Regjistrat që administron avokati ose noteri

Neni 72

Avokati ose noteri mban:

1) regjistrin e klientëve, marrëdhënieve të biznesit dhe transaksioneve sipas nenit 9 të këtij ligji;
2) regjistrin e të dhënave sipas nenit 43 paragrafi 1 të këtij ligji.

përmbajtjen e regjistrit të avokatit ose të noterit

Neni 73

Në regjistrat sipas nenit 72 të këtij ligji, mbahen dhe përpunohen të dhënat e mëposhtme:

1) emri personal, adresa e banimit, datëlindja dhe vendlindja e sipërmarrësit dhe e personit fizik që kryen aktivitetin ose shoqëria, selia dhe adresa dhe numri identifikues i personit juridik ose i sipërmarrësit të cilit i ofron shërbimet avokati ose noteri;
2) emri personal, adresa e banimit ose e qëndrimit, datëlindja dhe vendlindja e përfaqësuesit,

i cili vendos marrëdhënie biznesi ose kryen transaksion sipas pikës 1 të këtij paragrafi;
3) emri personal, adresa e banimit, datëlindja dhe vendlindja e personit të autorizuar që kryen transaksion sipas pikës 1 të këtij paragrafi
4) të dhënat sipas nenit 72 të këtij ligji në lidhje me personin juridik të cilit i ofron shërbime avokati ose noteri;
5) qëllimi dhe natyra e presupozuar e marrëdhënieve të biznesit, duke përfshirë informacionet për aktivitetin e klientit;
6) data e vendosjes së marrëdhënieve të biznesit;
7) data e kryerjes së transaksionit;
8) vlera dhe valuta e transaksionit;
9) destinacioni i transaksionit dhe emri personal dhe vendbanimi ose shoqëria dhe selia e subjektit të cilit i destinohet transaksioni;
10) mënyra e kryerjes së transaksionit;
11) të dhënat për burimin e pasurisë dhe mjeteve financiare të cilat janë objekt i marrëdhënieve të biznesit ose transaksionit;
12) emri personal, data dhe vendlindja, vendbanimi ose emri i shoqërisë, adresa dhe selia e personit për të cilin ka dyshime se është përfshirë në pastrim parash dhe financim të terrorizmit;
13) të dhënat për transaksionin për të cilin ka dyshime se lidhet me pastrim parash ose financim të terrorizmit (vlera, valuta, data ose periudha e kryerjes së transaksionit);
14) shkaqet e dyshimit për pastrim parash ose financim të terrorizmit.

Regjistrat që mban organi administrativ për çështjet doganore

Neni 74

Organi administrativ për çështjet doganore mban:
1) regjistrin për transportin e denoncuar ose të padenoncuar, përtej kufirit shtetëror, të parave, çeqeve, letrave me vlerë, metaleve ose gurëve të çmuar, vlera ose shuma e të cilave është 10 000 euro ose më shumë;
2) regjistrin për transportin ose përpjekjen për transport përtej kufirit shtetëror të parave, çeqeve, letrave me vlerë, metaleve ose gurëve të çmuar, me vlerë nën 10 000 euro, në qoftë se ka shkaqe për të dyshuar për pastrim parash ose financim të terrorizmit.

Përmbajtja e regjistrave të organit administrativ kompetent për shërbimet doganore

Neni 75

Në regjistrat e përmendur në nenin 74 të këtij ligji, mbahen dhe përpunohen të dhënat e mëposhtme:
1) emri personal, vendbanimi, datëlindja, vendlindja dhe shtetësia e personit fizik që transporton ose përpiqet të transportojë përmes kufirit shtetëror asetet e përcaktuara në nenin 74 të këtij ligji;
2) emri i shoqërisë, adresa dhe selia e personit fizik, ose emri personal, vendbanimi dhe shtetësia e personit fizik për të cilin kryhet transporti përmes kufirit shtetëror i aseteve të përmendura në nenin 74 të këtij ligji;
3) emri personal, vendbanimi dhe shtetësia e personit fizik ose emri i shoqërisë, adresa dhe selia e personit fizik, të cilit i dërgohen paratë;
4) vlera, valuta dhe lloji i parasë që transportohet përmes kufirit shtetëror;
5) burimi dhe qëllimi i përdorimit të parasë që transportohet përmes kufirit shtetëror;
6) vendi, data dhe ora e transportit ose përpjekjes për të transportuar përmes kufirit shtetëror;
7) arsyet e dyshimit për pastrim parash ose financim të terrorizmit.

Krahas të dhënave sipas paragrafit 1 të këtij neni, në regjistrin e përmendur në nenin 74 pika 2 të këtij ligji regjistrohet edhe nëse transporti i parasë i është raportuar organit administrativ kompetent për çështjet doganore.

Regjistrat që administron organi administrativ kompetent

Neni 76

Organi administrativ kompetent mban regjistra dhe të dhëna për:

1) personat dhe transaksionet sipas nenit 33 të këtij ligji;
2) personat dhe transaksionet sipas nenit 43 paragrafi 1 të këtij ligji;
3) kërkesat e marra sipas nenit 54 të këtij ligji;
4) njoftimeve dhe informacionet sipas neneve 55 dhe 56 të këtij ligji;
5) Kërkesat ndërkombëtare sipas paragrafëve 59 dhe 60 të këtij ligji;
6) veprat penale dhe shkeljet sipas nenit 68 të këtij ligji.

Përmbajtja e regjistrave që mban organi administrativ

Neni 77

Në regjistrat e të dhënave për personat dhe transaksionet sipas nenit 33 të këtij ligji, mbahen dhe përpunohen të dhënat e përmendura në nenin 71 të këtij ligji në lidhje me pezullimin e përkohshëm të transaksioneve të parashikuara në nenin 51 të këtij ligji.

Në regjistrin e të dhënave për personat dhe transaksionet sipas nenit 43 paragrafi 1 të këtij ligji, mbahen dhe përpunohen të dhënat sipas nenit 72 të këtij ligji në lidhje me pezullimin e përkohshëm të transaksionit.

Në regjistrin sipas nenit 76 pika 3 të këtij ligji, mbahen dhe përpunohen të dhënat e mëposhtme:

1) emri personal, datëlindja, vendlindja, vendbanimi, ose emri i shoqërisë, adresa dhe selia e personit për të cilin ka arsye të dyshohet për pastrim parash ose financim të terrorizmit;
2) të dhëna rreth transaksioneve për të cilat ka arsye për të dyshuar për pastrim parash ose financim të terrorizmit (vlera, valuta, data dhe periudha e kryerjes së transaksionit);
3) arsyet e dyshimit për pastrim parash ose financim të terrorizmit.

Në regjistrin sipas nenit 76 pika 4 të këtij ligji mbahen dhe përpunohen të dhënat si vijon:

1) emri personal, datëlindja, vendlindja, vendbanimi, ose emri i shoqërisë, adresa dhe selia e personit për të cilin ka përcjellë raportin dhe informacionin organi kompetent;
2) të dhëna rreth transaksioneve për të cilat ka arsye të dyshohet se lidhen me pastrim parash ose financim të terrorizmit (vlera, valuta, data dhe periudha e kryerjes së transaksionit);
3) të dhëna rreth dënimeve të mëparshme;
4) të dhëna për organin të cilit i janë përcjellë raporti dhe informacioni.

Në regjistrin sipas nenit 76 pika 5 të këtij ligji mbahen dhe përpunohen të dhënat e mëposhtme:

1) emri personal, datëlindja, vendlindja, vendbanimi, ose emri i shoqërisë, adresa dhe selia e personit me të cilin lidhet kërkesa;
2) emri i shtetit dhe emri i organit të cilit i drejtohet kërkesa ose i organit që ka paraqitur kërkesën.

Në regjistrin sipas nenit 76 pika 6 të këtij ligji mbahen dhe përpunohen të dhënat e mëposhtme:

1) emri personal, datëlindja, vendlindja, vendbanimi, ose emri i shoqërisë, adresa dhe selia e personit për të cilin nxirren jashtë shtetit të dhënat;
2) emri i shtetit dhe emri i organit të cilit i dërgohen të dhënat.

Përmbajtja e regjistrave për personat jorezidentë

Neni 78

Në regjistrat sipas nenit 77 të këtij ligji nuk regjistrohet numri identifikues tatimor i personave jorezidentë, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky ligj.

Regjistri i aksesit të organeve mbikëqyrëse në të dhënat, informacionet dhe dokumentet

Neni 79

Tatimpaguesi, avokati ose noteri duhet të mbajnë regjistra të veçantë për aksesin e organeve mbikëqyrëse sipas nenit 86 të këtij ligji në të dhënat, informacionet dhe dokumentacionin sipas nenit 80 të këtij ligji.

Regjistri sipas paragrafit 1 të këtij neni përfshin të dhënat e mëposhtme:

1) emrin e organit mbikëqyrës;
2) emrin e personit të autorizuar zyrtar që ka kontrolluar të dhënat;
3) datën dhe orën e kontrollimit të të dhënave.

Për çdo akses të organeve mbikëqyrëse sipas nenit 86 të këtij ligji në të dhënat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, tatimpaguesi, avokati ose noteri, duhet të njoftojë me shkrim organin administrativ kompetent, brenda tre ditësh nga data e kryerjes së kontrollit.

2. Mbrojtja e të dhënave

Ndalimi i nxjerrjes së informacionit

Neni 80

Tatimpaguesit dhe punonjësit e tatimpaguesit, anëtarët e organeve administrative, mbikëqyrëse dhe të organeve të tjera, ose persona të tjerë të cilëve u janë vënë në dispozicion të dhënat sipas nenit 71 të këtij ligji, nuk duhet t'u tregojnë palëve të treta, se:

1) organit administrativ kompetent i janë dhënë të dhëna, informacione ose dokumentacione rreth klientit ose transaksionit sipas nenit 33 paragrafët 2, 3 dhe 4, nenit 43 paragrafi 1, nenit 48 paragrafët 1, 2 dhe 3 dhe nenit 49 paragrafët 1 dhe 2 të këtij ligji;
2) organi administrativ kompetent, në bazë të nenit 51 të këtij ligji, ka kërkuar pezullim të përkohshëm të transaksionit ose e ka udhëzuar tatimpaguesin në lidhje me këtë;
3) organi administrativ kompetent, në bazë të nenit 53 të këtij ligji, ka kërkuar monitorim të rregullt të klientëve;
4) ndaj klientit ose një subjekti të tretë është nisur ose mund të nisë një hetim për pastrim parash ose financim të terrorizmit.

Nxjerrje informacioni në kuptim të këtij neni nuk konsiderohet përpjekja për t'i ndryshuar mendjen klientit që të mos përfshihet në aktivitet të paligjshëm.

Informacionet për faktet sipas paragrafit 1 të këtij neni, raportimet e transaksioneve të dyshimta, si dhe të gjitha të dhënat, informacionet ose dokumentacione të tjera që organi administrativ kompetent mbledh në përputhje me këtë ligj, cilësohen me shkallë e duhur të konfidencialitetit dhe nuk duhet t'u jepen palëve të treta.

Organi administrativ kompetent nuk është i detyruar të konfirmojë dhe as të kundërshtojë ekzistencën e të dhënave konfidenciale.

Për heqjen e shkallës së konfidencialitetit sipas paragrafit 3 të këtij neni vendos personi i ngarkuar i organit administrativ kompetent, në përputhje me këtë ligj.

Ndalimi i nxjerrjes së të dhënave sipas paragrafit 1 nuk zbatohet për:

1) të dhënat, informacionet dhe dokumentacionet të cilat, në përputhje me këtë ligj, merren dhe mbahen nga tatimpaguesi si të domosdoshme për konfirmimin e fakteve në procese penale, si dhe në qoftë se mbajtja e këtyre të dhënave kërkohet ose urdhërohet me shkrim nga gjykata kompetente;
2) të dhënave sipas pikës 1 të këtij paragrafi, në qoftë se kërkohet nga organi mbikëqyrës i përmendur në nenin 86 të këtij ligji, për zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të miratuara në bazë të këtij tij.

Përjashtime nga ruajtja e konfidencialitetit

Neni 81

Gjatë dërgimit të të dhënave, informacioneve dhe dokumentacionit organit administrativ kompetent në përputhje me këtë ligj, detyrimi i ruajtjes së sekretit të biznesit, sekretit bankar dhe sekretit profesional nuk zbatohet për tatimpaguesit, organizatat me kompetenca publike, organet shtetërore, gjykatat, avokatët ose noterët dhe punonjësit e tyre.

Tatimpaguesi, avokati ose noteri dhe punonjësit e tyre, nuk mbajnë përgjegjësi për dëmin e shkaktuar ndaj klientëve ose personave të tretë, në qoftë se në përputhje me këtë ligj:

1) i dërgojnë organit administrativ kompetent të dhëna, informacion dhe dokumentacion për klientët e tyre;
2) marrin dhe përpunojnë të dhëna, informacione dhe dokumente rreth klientëve;

3) zbatojnë urdhrin e organit administrativ kompetent për pezullim të përkohshëm të transaksionit;
4) zbatojnë kërkesën e organit administrativ kompetent për monitorim të rregullt të veprimtarisë financiare të klientëve.

Punonjësit e tatimpaguesit, avokatit ose noterit, nuk mund të mbajnë përgjegjësi disiplinoret ose penale për shkeljet e detyrimit të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave, në rast se:

1) të dhënat, informacionet dhe dokumentacionin ia dërgojnë organit administrativ kompetent në përputhje me këtë ligj;
2) të dhënat, informacionet dhe dokumentacionet e marra në përputhje me këtë ligji, i përpunojnë për qëllime të verifikimit të klientëve dhe transaksioneve, për të cilat ka arsye për të dyshuar se lidhen me pastrim parash ose financim të terrorizmit.

Përdorimi i të dhënave të marra

Neni 82

Organi administrativ kompetent, organet shtetërore dhe mbajtësit e autorizimeve publike, tatimpaguesit, avokatët ose noterët dhe punonjësit e tyre, duhet t'i përdorin të dhënat, informacionet dhe dokumentacionin e marrë në përputhje me këtë ligj vetëm për qëllimet për të cilat janë marrë.

Ruajtja e të dhënave

Neni 83

Tatimpaguesi është i detyruar që të dhënat e marra në bazë të neneve 9, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 26, 27 dhe 30 të këtij ligji, dhe dokumentacionin përkatës t'i ruajë për 10 vjet pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, transaksioneve të kryera, hyrjes së klientit në ambientet në të cilat organizohen lojëra të posaçme fati ose kumari.

Tatimpaguesi është ka detyrimin që të dhënat dhe dokumentacionin shoqërues për personin e autorizuar dhe zëvendësin e personit të autorizuar, trajnimin profesional të punonjësve dhe zbatimin e masave të kontrollit të brendshëm sipas neneve 35, 39 dhe 40 të këtij ligji, t'i ruajë për katër vjet pas shkarkimit nga detyra të personit të autorizuar dhe zëvendësit të personit të autorizuar ose të ofruesit të trajnimit profesional dhe kontrollit të brendshëm.

Avokati ose noteri është i detyruar që të dhënat e marra në bazë të nenit 42 paragrafi 1 të këtij ligji dhe dokumentacionin përkatës, t'i ruajë deri në 10 vjet pas përcaktimit të identitetit të klientit.

Avokati ose noteri kanë detyrimin që të dhënat dhe dokumentacionin shoqërues për trajnimin profesional të punonjësve t'i ruajnë për katër vjet pas kryerjes së trajnimit profesional.

Ruajtja e të dhënave tek organi kompetent për çështjet doganore

Neni 84

Organi kompetent për çështjet doganore i ruan dhënat nga regjistrat e përmendur në nenin 74 të këtij ligji për 11 vjet pas datës së marrjes, datë pas së cilës ato asgjësohen.

Ruajtja e të dhënave në organin administrativ kompetent

Neni 85

Organi administrativ kompetent ka detyrimin që të dhënat dhe informacionet e mbajtura sipas këtij ligji t'i ruajë për 11 vjet nga data e marrjes së tyre, datë pas së cilës ato asgjësohen.

Organi administrativ kompetent nuk duhet të informojë personin, të dhënat dhe informacionet e të cilit disponon, përpara skadimit të afatit prej 10 vjetësh nga data e marrjes së tyre.

Personat sipas paragrafit 2 i të këtij neni kanë të drejtë t'i shohin të dhënat e tyre personale pas skadimit të afatit prej 10 vjetësh nga data e marrjes së tyre.

VIII. MBIKËQYRJA

Neni 86

Mbikëqyrja e zbatimit të këtij ligji dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji, në kuadrin e kompetencave të përcaktuara, kryhet nga:

1) Banka Qendrore e Malit të Zi, tatimpaguesit sipas nenit 4 paragrafi 1 pikat 1, 2, 3, 10 dhe 13;
2) Agjencia e Telekomunikacionit dhe Shërbimit Postar, tatimpaguesit sipas nenit 4 paragrafi 1 pika 4;
3) Komisioni i Letrave me Vlerë, tatimpaguesit sipas nenit 4 paragrafi 1 pikat 5, 6 dhe 7;
4) Agjencia për Mbikëqyrjen e Sigurimit, tatimpaguesit sipas nenit 4 paragrafi 1 pika 8;
5) Organi administrativ kompetent për lojërat e fatit, nëpërmjet personit të autorizuar zyrtarisht në përputhje me ligjin që rregullon mbikëqyrjen inspektuese, tatimpaguesit sipas nenit 4 paragrafi 1 pika 9;
6) Organi tatimor, tatimpaguesit sipas nenit 4 paragrafi 1 pika 11;
7) Ministria kompetente për çështjet financiare, tatimpaguesit sipas nenit 4 paragrafi 1 pika 12;

7a) Dhoma e Avokatisë e Malit të Zi, avokatët dhe zyrat e avokatisë;

7b) Dhoma Noteriale e Malit të Zi, noterët;

8) Organi administrativ kompetent për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, nëpërmjet personit të autorizuar zyrtarisht në përputhje me ligjin që rregullon mbikëqyrjen inspektuese, tatimpaguesit sipas nenit 4 paragrafi 1 pikat 14 dhe 15.

Organet mbikëqyrëse sipas paragrafit 1 pikat 1 deri në 8 të këtij neni, përpara kryerjes së kontrollit, duhet të informojnë organin administrativ kompetent për aktivitetet e mbikëqyrjes që planifikojnë të kryejnë dhe, sipas nevojës, të koordinojnë dhe përshtatin veprimtarinë e tyre në kryerjen e mbikëqyrjes me zbatimin e këtij ligji.

Neni 87

Në qoftë se personi i autorizuar zyrtarisht i organit administrativ kompetent për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në procedurën e mbikëqyrjes inspektuese tek tatimpaguesi, mëson se ekzistojnë dyshime se është kryer vepra penale e pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit ose ndonjë vepër tjetër penale sipas nenit 56 të këtij ligji, mund ta marrë dokumentacionin tatimpaguesit dhe t'ia kalojë për shqyrtim organit kompetent.

Neni 88

Në qoftë se organi administrativ kompetent për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, gjatë përpunimit të çështjes, zbulon se ka dyshime se është kryer një vepër penale sipas nenit 56 të këtij ligji, ai duhet t'ia përcjellë të dhënat, informacionin dhe dokumentacionin që evidenton këtë organeve të tjera kompetente.

Neni 89

Organet sipas nenit 86 të këtij ligji janë të detyruara që për masat e marra dhe mbikëqyrjen e kryer në përputhje me këtë ligj, të njoftojnë organin administrativ kompetent brenda tetë ditësh nga data e marrjes së masave.

Organi administrativ kompetent mban regjistrin e masave dhe organeve sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Në qoftë se gjatë kontrollit inspektues, organet mbikëqyrëse sipas nenit 86 të këtij ligji, vlerësojnë se ka arsye për të dyshuar se ndonjë transaksion ose person lidhet me pastrim parash ose financim të terrorizmit, ose nëse përcakton fakte të cilat mund t'i lidhin ato me pastrim parash ose financim të terrorizmit, ato duhet të informojnë menjëherë organin administrativ kompetent.

Neni 90

Për kërkesën e paraqitur për nisjen e procedurave për kundërvajtje për shkak të veprimit në kundërshtim me këtë ligj, organi administrativ kompetent duhet të njoftojë organin kompetent të kontrollit (mbikëqyrjes) ose Dhomën e Avokatëve, në rastin kur kërkesa është paraqitur kundër avokatit.

IX. PROCEDURA PËR KUNDËRVAJTJE

Neni 91

fshihet. “Fletorja zyrtare e Malit të Zi” nr. 14/12)

X. DISPOZITAT PENALE

Neni 92

Personat juridikë dënohen me gjobë nga 2500 EUR deri në 20 000 Euro për shkeljet e mëposhtme:

1) nuk përpunon analizën e rrezikut ose nuk përcakton vlerësimin e rrezikut të secilit grup ose lloj klienti, marrëdhënieje biznesi, transaksioni ose produkti (neni 8);
2) nuk zbaton masat përkatëse sipas nenit 10 të këtij ligji gjatë vendosjes së marrëdhënieve të punës me klientin (neni 9 paragrafi 1 pika 1);
3) nuk zbaton masat përkatëse sipas nenit 10 të këtij ligji gjatë një ose disa transaksioneve të lidhura me vlerë 15 000 EUR ose më shumë (neni 9 paragrafi 1 pika 2);
4) nuk zbaton masat përkatëse sipas nenit 10 të këtij ligji kur ka dyshime për saktësinë ose besueshmërinë e të dhënave të marra për identifikimin e klientit (neni 9 paragrafi 1 pika 3);
5) nuk zbaton masat përkatëse sipas nenit 10 të këtij ligji kur transaksionin ose klientin ka dyshime për pastrim parash ose financim të terrorizmit (neni 9 paragrafi 1 pika 4);
6) vendos marrëdhënie pune me klientin pa marrë paraprakisht masat e parashikuara në nenin 10 paragrafi 1 pikat 1 dhe 2 të këtij ligji (neni 11 paragrafi 1);
7) kryen transaksionin ndërsa pa marrë paraprakisht masat me e parashikuara (neni 12);
8) nuk përcakton dhe nuk verifikon identitetin e personit fizik ose të përfaqësuesit ligjor, të sipërmarrësit ose të personit fizik që kryen aktivitetin, të personit juridik, të përfaqësuesit të personit juridik, të personit të autorizuar dhe të pronarit real ose të një subjekti të ngjashëm juridik të huaj, ose nuk merr të dhënat e parashikuara ose nuk i nxjerr ato në mënyrë të rregullt ose nuk nxjerr autorizim me shkrim të noterizuar për përfaqësim (neni 14, 15, 16, 17 dhe 20);
9) përcakton dhe verifikon identitetin e klientit nëpërmjet përdorimit të ekstraktit të kualifikuar elektronik në mënyrë të gabuar (neni 14 paragrafi 5);
10) nuk përcakton dhe nuk verifikon identitetin e klientit gjatë hyrjes së tij në ambientet në të cilat organizohen lojëra të posaçme fati ose gjatë çdo aksesi të klientit në kumar ose nuk merr të dhënat e parashikuara ose nuk i merr ato në mënyrë e parashikuar (nen 18);
11) vepron në kundërshtim me nenin 21 të këtij ligji;
12) vepron në kundërshtim me nenin 26 të këtij ligji;
13) nuk merr të dhëna për burimin e mjeteve financiare dhe pasurisë, të cilat janë objekt i marrëdhënieve të biznesit ose transaksionit, për sa u përket dokumenteve personale ose të ngjashme të dorëzuara nga klienti dhe nëse të dhënat e kërkuara nuk mund t’i marrë nga dokumentet e dorëzuara, nuk i merr ato drejtpërdrejt nga deklarata me shkrim e klientit (neni 27 paragrafi 4 pika 1);
14) nuk merr miratim me shkrim të personit përgjegjës përpara vendosjes së marrëdhënieve të biznesit me klientin (neni 27 paragrafi 4 pika 2);
15) pas vendosjes së marrëdhënieve të biznesit,nuk monitoron me vëmendje të veçantë transaksionet ose aktivitetet e tjera të biznesit të personave të ekspozuar politikisht në institucion (neni 27 paragrafi 4 pika 3);
16) në kuadrin e verifikimit të thelluar të klientit, nuk zbaton një ose disa masa shtesë sipas nenit 28 të këtij ligji;
17) kryen verifikim të thjeshtuar të klientit, në kundërshtim me nenin 29 të këtij ligji;
18) në kuadrin e verifikimit të thjeshtuar të klientit, nuk merr të dhënat e kërkuara të klientit në mënyrën e përshkruar (neni 30);
19) klientëve u hap, jep ose mban për ta llogari anonime, libreza kursimi me shifër ose ofron shërbime të ndryshme (produkte bankare) të cilat, në mënyrë indirekt ose direkte, mundësojnë fshehjen e identitetit të klientit (neni 31);
20) vendos ose zgjeron marrëdhëniet korrespondente me bankën, e cila operon ose mund të operojë si bankë “guaskë” ose me një institucion tjetër të ngjashëm kreditues, i clii dihet

se lejon përdorimin e llogarive të tij nga bankat "guaskë" (neni 32);

21) nuk i dërgon organit administrativ kompetent të dhënat e përshkruara, në afatin e parashikuar me ligj, kur në lidhje me transaksionin ose transaksionin dhe klientin e njoftuar ka arsye për të dyshuar për pastrim parash ose financim të terrorizmit (neni 33);
22) nuk i dërgon organit administrativ kompetent, me shkrim dhe në mënyrën e parashikuar, të dhënat, informacionet dhe dokumentacionin, kur në lidhje me transaksionin ose personin ka arsye për të dyshuar për pastrim parash ose financim të terrorizmit (neni 48);
23) vepron në kundërshtim me nenin 51 dhe nenin 62 paragrafi 1 të këtij neni;
24) nuk vepron sipas kërkesës së organit administrativ kompetent për monitorimin e operacioneve financiare të një klienti të caktuar (neni 53 paragrafët 1, 2 dhe 3).

Për shkeljet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, personi përgjegjës i subjekt juridik dhe personi fizik dënohet me gjobë nga 300 EUR deri në 2000 Euro.

Për shkeljet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, sipërmarrësi dënohet me gjobë nga 500 EUR deri në 6000 euro.

Neni 93

Personat juridikë dënohen me gjobë nga 2500 euro deri në 15 000 euro për shkeljet e mëposhtme:

1) nuk kryen identifikimin e klientit (neni 10 paragrafi 1 pika 1);
2) nuk përcakton procedura për zbatimin e masave të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji në aktet e tij të brendshme;
3) nuk mbledh të dhëna të sakta dhe të plota për paguesin transfertës elektronike ose nuk i hedh ato në formular ose në porosinë që monitoron kalimin elektronik të mjeteve financiare të dërguara ose të marra, pavarësisht nga valuta (neni 12a paragrafi 1);
4) nuk refuzon të kryejë transfertën e mjeteve financiare në qoftë se të dhënat për paguesin nuk janë të plota, ose nuk kërkon plotësimin e tyre në afatin më të shkurtër të mundshëm (neni 12a paragrafi 3);
5) nuk monitoron operacionet financiare të klientit (neni 22 paragrafi 1);
6) nuk kryen kontrollin e përsëritur vjetor të personit juridik të huaj, nuk merr të dhënat e parashikuara, ose nuk i merr ato në mënyrën e parashikuar (neni 23);
7) nuk përcakton me akt të brendshëm procedurën e identifikimit të personave të ekspozuar politikisht (neni 27 paragrafi 5);
8) nuk merr masa dhe veprime për shmangien e rrezikut që mund të shfaqet nga përdorimi i teknologjive të reja (neni 28a paragrafi 1);
9) nuk miraton aktet të brendshme për parandalimin e përdorimit të teknologjive të reja për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit (neni 28a paragrafi 2);
10) nuk i dërgon organit administrativ kompetent, në afatin e parashikuar, të dhënat e përshkruara për transaksionin që do të kryhet në para kesh në vlerën mbi 15 000 euro (neni 33 paragrafi 1);
11) Nuk siguron zbatimin e masave për zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, të përcaktuara me këtë ligj, tek njësitë e saj operuese ose shoqëritë me pronësinë më të madhe të cilat kanë selinë në shtet tjetër (neni 34 paragrafi 1);
12) nuk cakton një person të autorizuar dhe zëvendësin e tij për kryerjen e veprimeve dhe detyrave të zbulimit dhe parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (neni 35 paragrafët 3 dhe 4);
13) Personit të autorizuar nuk i siguron kushtet përkatëse sipas nenit 38 të këtij ligji;
14) Nuk ruan të dhënat dhe dokumentacionin në përputhje me nenin 83 të këtij ligji.

Për shkeljet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni dënohet edhe personi përgjegjës në subjektin juridik dhe personi fizik, me gjobë nga 300 euro deri në 1000 euro.

Për shkeljet sipas paragrafit 1 të këtij neni sipërmarrësi dënohet me gjobë nga 500 euro deri në 6000 euro.

Neni 94

Personat juridikë dënohen me gjobë nga 1000 euro deri në 6000 euro për shkeljet e mëposhtme:

1) Nuk monitoron aktivitetet e biznesit të klientit në bazë të nenit 22 paragrafi 2 të këtij ligji;

2) nuk analizon të gjithë transaksionet e pazakonta të mëdha të cilat nuk kanë qëllim të qartë ekonomik ose juridik dhe rezultatet e analizës nuk i evidenton me shkrim (neni 33a paragrafët 1 dhe 2);
3) nuk përcakton me akt të brendshëm listën me kriteret për dallimin e transaksioneve të pazakonta (neni 33a paragrafi 3);
4) nuk njofton organin administrativ kompetent dhe nuk merr masat përkatëse për shmangien e rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (neni 34 paragrafi 2);
5) nuk siguron që punën e personit të autorizuar dhe zëvendësit të personit të autorizuar ta kryejë personi që plotëson kushtet e parashikuara (neni 36);
6) nuk i dërgon organit administrativ kompetent, në mënyrën e parashikuar me shkrim, të dhënat për emrin personal dhe titullin e vendit të punës të personit të autorizuar ose të zëvendësit të personit të autorizuar, si dhe çdo ndryshim të këtyre të dhënave (neni 38 paragrafi 3);
7) nuk siguron aftësim të rregullt profesional dhe trajnim të punonjësve që kryejnë detyrat e zbulimit dhe të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në përputhje me këtë ligj (neni 39 paragrafi 1);
8) nuk përgatit në afatin e parashikuar programin e aftësimit profesional dhe të trajnimit për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit (neni 39 paragrafi 2);
9) nuk siguron kontroll të rregullt të brendshëm të kryerjes së veprimeve të zbulimit dhe parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në bazë të këtij ligji (neni 40);
10) nuk shfrytëzon listën e treguesve sipas nenit 45 paragrafi 1 i këtij ligji gjatë konfirmimit të bazës së dyshimit se bëhet fjalë për pastrim parash ose financim të terrorizmit dhe rrethanave të tjera në lidhje me këtë;
11) nuk ruan të dhënat dhe dokumentacionin për personin e autorizuar dhe zëvendësin e tij, për trajnimin profesional të punonjësve dhe masat e zbatuara të kontrollit të brendshëm sipas neneve 35, 39 dhe 40 të këtij ligji për katër vjet pas shkarkimit të personit të autorizuar ose zëvendësit të tij, si dhe për përgatitjen profesionale dhe kontrollin e brendshëm të kryer (neni 83 paragrafi 2).

Për shkelje sipas paragrafit 1 të këtij neni dënohet edhe personi përgjegjës në subjektin juridik dhe personi fizik, me gjobë nga 200 euro deri në 1000 euro.

Për shkelje sipas paragrafit 1 të këtij neni, sipërmarrësi dënohet me gjobë nga 500 euro deri në 3000 euro.

Neni 95

Me gjobë nga 3000 deri në 20 000 euro dënohet për shkelje personi i regjistruar për verifikim të certifikuar të vërtetimit elektronik në qoftë se, me kërkesë të tatimpaguesit, nuk dërgon kopjen e dokumentit dhe dokumentacionet e tjera në bazë të të cilave ka përcaktuar dhe verifikuar identitetin e klientit (neni 14 paragrafi 4).

Për shkelje sipas paragrafit 1 të këtij neni personi përgjegjës në subjektin juridik të regjistruar për verifikim të certifikuar të vërtetimit elektronik dënohet me gjobë nga 300 euro deri në 3000 euro.

Neni 96

Avokati ose noteri dënohen për shkelje me gjobë nga 3000 euro deri në 20 000 euro nëse:

1) vepron në kundërshtim me nenin 21 të këtij ligji;
2) në kuadrin e verifikimit të klientit, nuk merr të gjitha të dhënat e parashikuara në përputhje me këtë ligj (neni 42 paragrafët 1, 2 dhe 3);
3) nuk përcakton dhe nuk verifikon identitetin e klientit ose të përfaqësuesit të tij ose të personit të autorizuar, ose nuk i merr të dhënat e parashikuara në mënyrën e parashikuar (neni 42 paragrafët 4, 6 dhe 7);
4) nuk njofton organin administrativ kompetent në afatin e parashikuar se në lidhje me ndonjë transaksion ose transaksion të planifikuar ose person të caktuar ka arsye për të dyshuar për pastrim parash ose financim të terrorizmit (neni 43 paragrafët 1, 2 dhe 3);
5) nuk njofton organin administrativ kompetent që klienti ka kërkuar këshilla në lidhje me

pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit (neni 43 paragrafi 4);

6) nuk i dërgon organit administrativ kompetent kopjen e noterizuar të kontratave të shitblerjeve lidhur me tregtinë e pasurive të paluajtshme (pasuri) vlera e të cilave kalon 15 000 euro (neni 43 paragrafi 5);
7) nuk lajmëron organin administrativ kompetent mbi transaksionet në para sipas nenit 33 paragrafi 1 të këtij ligji, kur në lidhje me transaksionin ose klientin ka arsye për të dyshuar se bëhet fjalë për pastrim parash ose financim të terrorizmit (neni 44 paragrafi 3);
8) nuk cakton personin e autorizuar dhe zëvendësin e tij për kryerjen e detyrave të caktuara në lidhje me zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit që parashikohen me këtë ligj dhe me aktet nënligjore të miratuara në bazë të ligjit (neni 35 paragrafët 3 dhe 4 në lidhje me nenin 41 paragrafi 1);
9) nuk i siguron personit të autorizuar kompetencat përkatëse, kushtet dhe ndihmën për kryerjen e punëve dhe detyrave të tij (neni 38 paragrafët 1 dhe 2 në lidhje me nenin 41 paragrafi 1);
10) nuk përcakton pronarin real, i cili është person juridik ose ndonjë formë tjetër e ngjashme organizimi e personit juridik të huaj, ose nuk merr të dhënat e parashikuara ose nuk i merr ato në mënyrën e parashikuar (neni 42 paragrafët 5 dhe 7);
11) nuk i dërgon të dhënat, informacionet dhe dokumentacionin sipas nenit 49 paragrafi 4 të këtij ligji në afatin dhe mënyrën e parashikuar;
12) nuk garanton që punën e personit të autorizuar dhe të zëvendësit të tij ta kryejë personi që plotëson kushtet (neni 36 në lidhje me nenin 41 paragrafi 1);
13) nuk i dërgon organit administrativ kompetent në afatin e parashikuar të dhënat për emrin personal dhe titullin e vendit të punës të personit të autorizuar dhe të zëvendësit të tij, si dhe çdo ndryshim të këtyre të dhënave (neni 38 paragrafi 3 në lidhje me nenin 41 paragrafi 1);
14) nuk kryen përgatitje dhe trajnim të rregullt profesional të punonjësve që kryejnë detyra që lidhen me zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në përputhje me këtë ligj (neni 39 paragrafi 1 në lidhje me nenin 41 paragrafi 1);
15) nuk përgatit në afatin e parashikuar programin e përgatitjes dhe të trajnimit profesional për zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit (neni 39 paragrafi 2 në lidhje me nenin 41 paragrafi 1);
16) nuk siguron kontroll të rregullt të brendshëm të detyrave që lidhen me zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në bazë të këtij ligji (neni 40 në lidhje me nenin 41 paragrafi 1);
17) nuk i dërgon organit administrativ kompetent arsyet për shkak të të cilave nuk është vepruar në bazë të kërkesës së tyre ose për shkak të cilave nuk i dërgon ato në afatin e parashikuar (neni 44 paragrafi 2);
18) në rastin e konfirmimit të bazës së dyshimit për pastrim parash ose financim të terrorizmit dhe të rrethanave të tjera në lidhje me të, nuk shfrytëzon listën e treguesve sipas nenit 45 paragrafi 1;
19) nuk ruan të dhënat e marra në bazë të nenit 42 paragrafi 1 të këtij ligji dhe dokumentacionin përkatës 10 vjet pas konfirmimit të identitetit të klientit (neni 83 paragrafi 3);
20) nuk ruan të dhënat dhe dokumentacionin mbi aftësimin profesional për katër vjet pas trajnimit (neni 83 paragrafi 4).

Neni 96a

Në rast shkeljesh veçanërisht të rënda ose përsëritje të shkeljeve të përmendura në nenet 92 dhe 96 të këtij ligji, personit juridik dhe sipërmarrësit mund t'i komunikohet masa e ndalimit të kryerjes së aktivitetit për një periudhë dyvjeçare, ndërsa personit përgjegjës në subjektin juridik dhe personit fizik mund t'u komunikohet masa e ndalimit të kryerjes së aktiviteteve tregtare pre një periudhë dyvjeçare.

XI. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 97

Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji miratohen brenda gjashtë muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Deri në miratimin e aktit nënligjor sipas paragrafit 1 të këtij neni do të zbatohen aktet nënligjore të miratuara në bazë të ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" ("Fletorja zyrtare e Republikës së Malit të Zi" nr. 55/03, 58/03 dhe 17/05), në qoftë se nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 97a

Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji miratohen brenda gjashtë muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 97b

Tatimpaguesit duhet ta përshtatin biznesin e tyre me nenet 12a, 28 a dhe 33a të këtij ligji, brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 98

Tatimpaguesit duhet ta përshtatin biznesin e tyre me këtë ligj brenda gjashtë muajsh nga data e hyrjes në fuqi të dispozitave të nenit 97 të këtij ligji.

Neni 99

Procedurat e nisura në përputhje me ligjin "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" ("Fletorja zyrtare e Republikës së Malit të Zi" nr. 55/03, 58/03 dhe 17/05) do të vazhdojnë sipas këtij ligji, nëse kjo është e përshtatshme për palën në proces.

Neni 100

Datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji pushon efekti i ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" ("Fletorja zyrtare e Republikës së Malit të Zi" nr. 55/03, 58/03 dhe 17/05).

Neni 101

Ky ligj hyn në fuqi tetë ditë pas botimit të tij në "Fletoren zyrtare të Malit të Zi".

SU-SK Numër 01-518/10
Podgoricë, më 29 nëntor 2007

Kuvendi i Malit të Zi
Kryetari,
Ranko Krivokapić, d.v.